



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.06.2023, ora 11:15

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i Raportit të veprimtarisë vjetore të Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2022.

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Eduard Ndreca, Florenc Spaho, Teuta Ramaj, Enslemvera Zake, Ilir Topi, Meri Markici, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Merita Bakiu dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Lindita Buxheli, Blerina Gjylameti, Dasantila Tahiraj dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Leka Bungo – Kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së,
Ilir Keko, Mevlan Shanaj, Edmond Tullumani, Ardita Reçi, Milena Selimi dhe Engjëll Ndocaj - anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së,

Redi Neziri – zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Melsi Qirici – drejtoreshë e Njesisë së Programeve në RTSH,

Bledar Zaganjori – drejtor i Njesisë së Lajmeve në RTSH,

Henri Muça – drejtor i Njesisë Teknike në RTSH,

Knidi Bashari – kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së,

Edvin Shvarc – shef Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm në RTSH,

Kristjana Mici – asistente e Këshillit Drejtues të RTSH-së.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, e mërkurë, datë 7 qershor, ora 11:14.

Në rendin e ditës sot kemi vetëm një pikë, është raportimi i veprimtarisë vjetore të Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2022.

Përveç anëtarëve të komisionit, kësaj radhe, ndryshe nga herët e tjera, me propozim të një pjese të këtij komisioni, është ftuar i gjithë Këshilli Drejtues i RTSH-së, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së. Përkatësisht në mbledhje kemi kryetarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, zotin Leka Bungo; zotin Ilir Keko, zotin Mevlan Shanaj, zotin Edmond Tullumani, zonjën Ardita Reçi, zonjën Milena Selimi dhe zotin Engjëll Ndocaj, anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Gjithashtu, zonjën Kristjana Mici, asistente e këtij Këshillit.

Mirë se keni ardhur!

Ndërkohë, nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së të ftuar kemi zotin Redi Neziri, zëvendës drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së; zonjën Melsi Qirici, drejtoreshë e Njesisë së Programeve; zotin Bledar Zaganjori, drejtor i Njesisë së Lajmeve; zotin Henri Muça, drejtor i Njesisë Teknike; zotin Knidi Bashari, kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së, si dhe zotin Edvin Shvarc, shef i Kabinetit të drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Mirë se keni ardhur të gjithë!

Sipas protokollit të zhvillimi të mbledhjeve në rastet kur ka raportime, gjithmonë fillohet me kryetarin në këtë rast. Nëse ju keni vendosur që një pjesë të këtij raportimi paraprak ta ndani në këtë rast me zëvendës drejtorin, atëherë do t'ia kalojmë fjalën zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së. Më pas, fjalën do ta marrë relatori dhe do të vazhdojmë më tej me pyetjet e kolegëve dhe natyrisht me përgjigjet tuaja.

Zoti Bungo, fjala është për ju.

Faleminderit!

Leka Bungo – Në të vërtetë kjo përmbledhje e raportit, të cilën do ta lexoj para jush, është një pjesë e raportit të përgatitur, në përgjithësi flas si Radiotelevizion, nga sektorët dhe departamente të ndryshme të RTSH-së, i cili më pas është miratuar edhe në Këshillin Drejtues të RTSH-së.

Unë po lexoj atë çka kemi menduar që është substanciale nga ky raport, sepse është tepër i gjatë, është shumëfaqësh dhe nuk mund të shkonte në një mbledhje të kësaj natyre.

Të nderuar deputetë,

Radiotelevizioni Shqiptar për arritjen e objektivave të tij ka në fokus kryesor të menaxhimit: punën në grup, marrjen e vendimeve për çështje organizative, programore dhe teknike nëpërmjet diskutimeve me strukturat përgjegjëse, respektimin e hierarkisë në vendimmarrje, përdorimin me efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve të RTSH-së nëpërmjet riorganizimit të Drejtorisë Ekonomike dhe të procedurave të miratimit të shpenzimeve, punësimin nëpërmjet procedurave standarde të rekrutimit, ku vlerësimi kryhet bazuar në meritokracinë e kandidatëve, zhvillimin profesional të stafit, nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, evidentimin dhe raportimin e problemeve të konstatuara.

Sa më sipër, vlerësojmë që të gjitha këto ndërmarrje dhe politika drejtimi kanë ndikuar në përmirësimin e frymës dhe kulturës së punës të grupit, të cilës vijojmë t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë.

Një nga sfidat më të mëdha është përshtatja me tregun, e cila duhet realizuar në perspektivë, duke sjellë për publikun produkte edukuese për të qenë konkurrues me cilësinë, por edhe me komercialitetin; produkte të shpejta dhe interesante; lajmin në kohë reale, me gazetarë që operojnë në terren me teknologjinë më të fundit, duke ndërtuar një rrjet më të gjerë gazetarësh e korrespondentësh; figura të dashura në ekran, personazhe që rrezatojnë energji pozitive dhe kulturë të pasur në komunikim.

Gjatë vitit 2022 RTSH-ja ka planifikuar vijimin e projekteve nga ku janë rivlerësuar të gjitha programet në transmetim dhe janë miratuar programet, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe përfaqësojnë interesin e të gjithë publikut të RTSH-së. Këtu përmendim blerje filma/seriale, programet për shëndetin, politikën, programe të natyrës *fact check* si një formë edukuese

gazetareske dhe që shton besimin tek audiencia sa i takon vërtetësisë së lajmit të mundësuar, programe nga aktualiteti e të tjera. Tashmë RTSH-ja vjen me një formulë të re programesh ditore.

Sa i përket informacionit, RTSH-ja ka vijuar të ruajë pavarësinë editoriale dhe paanshmërinë në dhënien e informacionit në edicionet e lajmeve.

Minoritetet etnike dhe kulturore gjatë vitit 2022 kanë qenë të angazhuara drejtpërdrejt në realizimin jo vetëm të lajmeve në gjuhët përkatëse, por edhe në realizimin dhe transmetimin e reportazheve dhe dokumentarëve që kanë ardhur si rezultat i bashkëpunimeve të institucioneve e shoqatave.

Me qëllim rritjen e audiencës së RTSH-së, duke mbajtur në vëmendje objektivat për të qenë sa më të fokusuar në të përditshmen, Drejtoria e Komunikimit në Web dhe Rrjete Sociale në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Shitjeve dhe Promocionit kanë promovuar RTSH-në, impakt ky i dukshëm që reflektohet si në formatet e reja të përdorura në rrjetet sociale, por edhe në sasinë e informacionit të shpërndarë në format elektronik, si forma aktuale me qasje më të lartë të paraqitjes së informacionit. Ka një trend në rritje të ndjekësve të kanalit të RTSH-së gjatë vitit 2022 nëpërmjet medieve sociale, që është edhe motori i kërkimit më i aksesueshëm aktualisht.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar arkivës së radios dhe të televizionit, që përkon me: ndërhyrjen në rikonstrukcion të ambienteve, si në rastin e ambienteve ku ruhen materialet “Film” apo në krijimin e ambienteve më të përshtatshme për një pjesë të fondit të radios, që është i vendosur në bodrume jashtë kushteve të ruajtjes së materialeve arkivore; një punë voluminoze për evidentimin e detajuar të të gjithë fondit arkivor në RTSH, për të specifikuar veçanërisht materialet e një rëndësie të madhe dhe që duhen të jenë domosdoshmërisht të përfshirë që në fazat e para në procesin e digjitalizimit.

Ka filluar puna për digjitalizimin e materialeve audio të fondit audio të Radio Tiranës duke përdorur pajisjet aktuale në teknikën e Radios. Në këtë kuadër është bashkërenduar puna edhe me qendrat vendore audiovizive për evidentimin e arkivave të tyre dhe listimin e pajisjeve teknike që ata disponojnë.

RTSH-ja është në dijeni të kushteve të krijuara viteve të fundit që nga pandemia dhe duke vijuar më pas me situatën e vështirë ekonomike globale, e cila ka përfshirë edhe vendin tonë; faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen financiare të RTSH-së dhe, nga ana tjetër, dimë që mungesa e fondeve për investime e bën të vështirë ndërmarrjen nga ana jonë të hapave të tjera për zhvillime,

pasi në vlerësimin e RTSH-së lind nevoja për investime në infrastrukturë teknologjike dhe ndërtimore.

RTSH-ja ka nisur punën me grupet përkatëse të punës për rishikim e pagave të stafit dhe të librit të tarifave për shërbimet e ofruara dhe të përfituar nga RTSH-ja nga palët e treta.

Bazuar në draftin paraprak të propozuar për ndryshimet e pagave është miratuar, për t'u mbajtur në vëmendje, fakti që nevoja e rritjes së pagave duhet shoqëruar me rritjen e financimit nëpërmjet buxhetit të shtetit apo rritjes së tarifës së aparatit.

Sa më sipër, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe ofrimin e projekteve artistike të tilla që të kenë interes për publikun dhe të tërheqë më shumë vëmendjen e shikuesit është e domosdoshme rritja e burimeve të financimit buxhetorë dhe të tarifës të aparatit gjë e cila do të bëjë të mundur mbulimin e kostove të studiove, skenografive, paga personeli, gjë e cila sjell përthithjen e personelit të specializuar dhe ideve të reja e krijuese.

Faktorë të rëndësishëm në RTSH janë dy burimet kryesore të financimit: financimi nga tarifa e aparatit, e cila vilet nëpërmjet OSHEE-së dhe është pothuajse në të njëjtat nivele çdo vit, duke qenë se vlera e tarifës është e pandryshuar që nga viti 2014, financimi 100 lekë për aparat; financimi buxhetor që është po në të njëjtat nivele me vitin paraardhës.

Për shkak të zhvillimeve politiko-ekonomike në të cilat është përfshirë ekonomia globale, duhet të përmendim që ndikimi në financat e RTSH-së është i ndjeshëm. Janë rritur kostot në realizimin e skenografive, në furnizimin me produkte të nevojshme për zhvillimin dhe plotësimin e detyrave funksionale të RTSH-së. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar optimizimit të burimeve financiare nëpërmjet rishikimit të procedurave të miratimit të shpenzimeve, pas ristrukturimit të Drejtorisë së Ekonomisë, procedurat e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, miratimi i dietave dhe shpenzimeve të udhëtimit, ndjekja e kontratave, e të tjera.

Spektori i projekteve, gjatë përgatitjes së kontratave, u ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve ligjore, që lidheshin me administrimin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të lidhura, në të gjitha rastet e lidhura me projektet artistike dhe blerjet e të drejtave të transmetimit audioviziv të filmave dokumentarë dhe të koncerteve muzikorë, duke mbrojtur interesat e RTSH-së, si dhe duke e çliruar RTSH-në nga të gjitha detyrimet financiare kundrejt agjencive që administrojnë në mënyrë kolektive të drejtat e autorit, si dhe të drejtat e lidhura, si dhe nga të gjitha detyrimet kundrejt palëve që administrojnë në mënyrë individuale këto të drejta.

Evente të veçanta kanë qenë transmetimet me informacione për luftën në Ukrainë, maratona e zgjedhjeve të pjesshme vendore të 6 marsit, protestat e shoqërisë civile gjatë muajit mars dhe festivali i Sanremos. Ky vit përkoi me zgjedhjet vendore të 14 majit, ngjarja më e rëndësishme në jetën shoqërore dhe politike në vend. Çdo aktivitet i subjekteve politike u pasqyrua me vërtetësi, paananësi, profesionalizëm, duke respektuar minutazhin për çdo parti politike.

Festivali i Këngës në Radio-Televizionin Shqiptar ka qenë dhe mbetet një nga ngjarjet kulmore artistike shqiptare. Në të marrin pjesë këngëtarë të rinj dhe këngëtarë të afirmuar. Fituesi i përzgjedhur nga votat e publikut këtë vit përfaqësoi më pas vendin tonë në Eurovizion.

Radios nuk i mungoi përsiatja mbi tema dhe detaje ofruar nga librat, reflektimi dhe nxitja drejt të bukurës dhe artit. Duke stimuluar atë që duhet të bëjë radio, pra t'i flasë dëgjuesit, nisëm emisionet e orëve të vona, duke i ruajtur magjinë dhe intimitetin radios.

Radio Tirana, për të përmbushur më së miri kërkesat e publikut të gjerë, në një javë kalendarike solli prodhime autentike realizuar nga potenciali njerëzor që garanton cilësi, por zhvillimi i vrullshëm në gjithçka, kërkon medoemos përditësim, nisur edhe nga përvoja e institucioneve të ngjashme, në rajon e në botë.

Nga sektori i shitjes janë hartuar paketat dhe strategjitë e shitjes të FIFA World Cup 2022, si evenimenti kryesor sportiv i vitit. Janë kontaktuar të gjitha subjektet dhe agjencitë që operojnë në treg, duke i klasifikuar sipas kategorive që përfaqësojnë. Gjithashtu, janë hartuar dhe shpërndarë ofertat publicitare për UEFA Champions League, FORMULA 1, Eurovision Song, EURO Women 2022, si dhe oferta për të gjitha programet e strukturës të RTSH-së.

Orkestra Simfonike e Radio-Televizionit Shqiptar ka vijuar aktivitetin e saj ku ka zhvilluar koncertet e Stinës Koncertore 2021-2022. Koncertet kanë qenë të një niveli të lartë artistik dhe profesional për shkak të punës së mirë që orkestra bëri, gjithashtu edhe për arsye sepse kishim prurje shumë të mira artistësh, dirigjentësh e solistësh.

Në vijim të traditës së Orkestrës Simfonike të RTSH-së, që sezonin artistik 2022-2023 e nisi me 60-vjetorin e krijimit të saj drejtuar dhe dirigjuar nga drejtori i ri artistik, vëmë në dukje se keni pasur rritje të ndjeshme të veprimtarisë me koncertet e programuara, të cilat vendosin në fokus orkestrën e RTSH-së në bashkëpunimin e saj me institucione të tjera si: Orkestrën e Kosovës, krijimin e një *young orchestra*, orkestra e të rinjve, në bashkëpunim me Liceun Artistik “Jordan Misja”.

Këshilli Drejtues i RTSH-së dhe Drejtoria e Përgjithshme, të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kanë, po rrisin ngarkesën për të vijuar me përgjegjshmëri e profesionalizëm punën në përmbushjen e misionit e të qëllimit që ka RTSH-ja. Ne besojmë se duke folur hapur e drejtë përpara jush, marrim vëmendjen e duhur për mbështetjen që na nevojitet për të realizuar një hap cilësor, që shkon në rezonancë me kërkesat e publikut.

Kjo është përmbledhja e bërë nga raporti që ne kemi dorëzuar pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Petro Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk e di nëse ka ndonjë gjë për të plotësuar zëvendës drejtori? Nuk ka.

Atëherë, fjalën e ka relatori, i cili, përveç relacionit të tij, do të lexojë edhe disa projekt rekomandime që kemi ne për vitin në vijim.

Zoti Spaho, fjala për ju.

Florenc Spaho – Faleminderit, drejtues i komisionit!

Së pari, më lejoni t'ju shpreh mirënjohjen time që jeni bërë pjesë e këtij komisioni. Është kënaqësi dhe nder për të gjithë komisionin që ka punuar me ju gjithë këto vjet, që një profesionist dhe një elitar si ju, është pjesë e këtij këshilli të nderuar. Shpresoj që të gjithë bashkë të nxjerrim të gjitha problematikat që duhen rregulluar dhe duhen parë me një sy, që nuk do të jetë vetëm sugjerues, por edhe kërkues nga të dyja palët. Në emër të komisionit më lejoni që të lexoj relacionin.

Raporti vjetor pasqyron në mënyrë të detajuar të gjithë aktivitetin e RTSH-së, përfshirë analizën e Drejtorisë së Lajmeve dhe emisionet tematike, raportin e njësisë teknike, raportet e departamenteve të tjera të institucionit, raportin ekonomik-financiar, informacionet për proceset gjyqësore ku RTSH-ja është palë.

RTSH-ja, për të gjithë opinionin publik, përbëhet nga tre organe drejtuese: Këshilli Drejtues, drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit.

Aktualisht, RTSH-ja transmeton një paketë programesh gjithëpërfshirëse prej 18 kanalesh, ku 6 kanale në rrjet janë radio, ndërsa rrjeti tjetër është për mbështetjen e transmetuesve audiovizivë rajonalë dhe vendorë, që kanë lidhur kontrat me Radiotelevizionin Shqiptar për këtë qëllim.

Tashmë RTSH-ja ka një formulë të re programesh ditore, ku çdo ditë, pas edicionit kryesor të lajmeve të orës 20:00, vijohet me një program të ri me natyrë të ndryshme politike, ekonomike, bujqësore, mjedisi e të tjera.

Për sa u përket të gjitha problematikave, që nxori edhe zoti Leka Bungo në raportin e koncentruar, në zbatim të kontratës që AMA ka me RTSH-në gjatë vitit 2022, AMA realizoi dy shqyrtime, një në muajin qershor dhe një në muajin dhjetor, ku në fokus kishin përmbajtjet e transmetuara nga kanalet e RTSH-së, si dhe të dhënat mbi mosmbulimin me sinjal të disa zonave të shërbimit në territorin e vendit tonë.

Për sa u përket këtyre problematikave, besoj se AMA ia ka vënë në dispozicion edhe RTSH-së, edhe Këshillit të Lartë Drejtues. Disa nga këto problematika janë informuar nga drejtuesit e RTSH-së për përpjekjet aktuale që po bëhen në procesin e gjetjes së ekspertëve të gjuhës së shenjave dhe pret rikthimin të përmbushja e detyrimeve që ka transmetuesi publik, sipas kontratës, për të aktivizuar standardin e shoqërimit të programeve të caktuara në këtë teknikë.

Gjithashtu, nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit rezulton se RTSH-ja nuk mbulon me shërbim audioviziv numerik 2,8% të popullsisë.

Në rekomandimet e bëra nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit janë pasqyruar 11 pika, të cilat do t'ia vëmë në dispozicion Këshillit Drejtues dhe drejtorit. Unë shpresoj që të marrin të gjithë vëmendjen e duhur për të gjetur një zgjidhje, e cila do të ishte në shërbim të qytetarëve dhe opinionit publik.

Këshilli Drejtues i RTSH-së, duhet:

1. Të informojë sa më parë Kuvendin në lidhje me prodhimet e porositura gjatë vitit 2022 nga fondi i prodhimit të pavarur.
2. Të bëhet transparente veprimtaria e Këshillit të Lartë Drejtues në faqen zyrtare *online* të RTSH-së, duke publikuar të gjitha vendimet e para të shoqëruara edhe me relacionet përkatëse.
3. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Bordit të Administrimit, duke publikuar aktivitetin e këtij bordi, të gjitha vendimet e marra dhe aktet e miratuara.
4. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit.
5. Të angazhohet në realizimin e sa më shumë emisioneve, programeve argëtuese, kulturore, edukative, prodhime të RTSH-së, për të rinjtë, konkretisht të grupmoshave 10 deri 14 vjeç, si dhe 15 deri 18 vjeç, me fokus të veçantë informimin dhe edukimin mbi fenomenin e bullizimit në këto grupmosha.

6. Të angazhohet në pasurimin e kanalit “RTSH Shkollë” me emisione kulturore, rubrika argëtuese, veçanërisht në fundjavë, si dhe me një programim më të përshtatshëm të transmetimeve në ditët e pushimeve shkollore, duke siguruar një gjithëpërfshirje gjeografike të shkollave në të gjithë territorin e vendit, duke pasqyruar aktivitetet artistike të këtyre shkollave.

7. Të angazhohet për transmetimin e programeve edukative të parashikuara në dispozitat e ligjeve specifike për mbrojtjen e shëndetit, siç është ligji nr.76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”.

8. Të publikojë në faqen zyrtare, përveç shpenzimeve të festivaleve, edhe shpenzimet për aktivitete të tjera të rëndësishme, si dhe të ardhurat e përfituara prej këtyre aktiviteteve në funksion të transparencës mbi përdorimin e fondeve publike.

9. Në “RTSH Kuvend” të përfshihen edhe përmbajtjet informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

10. Në kuadër të transparencës të publikohet në faqen zyrtare struktura organizative dhe organika e RTSH-së. Të reflektohen vakancat e krijuara dhe të jenë transparente të gjitha procedurat e rekrutimit.

11. Këshilli i Lartë Drejtues i RTSH-së të investohet në garantimin e planit strategjik të institucionit, për të siguruar qëndrueshmëri dhe vizion në drejtimin e transmetuesit publik.

12. Gjithashtu, në strukturën organizative të Radiotelevizionit Shqiptar, të sigurohet një strukturë e posaçme mbështetëse në funksion të veprimtarisë së Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit shqiptar për hartimin, vlerësimin dhe raportet e analizave, si dhe për publikimin e tyre në hapësirën e dedikuar në faqen zyrtare.

Faleminderit, zoti drejtues i komisionit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Spaho!

Atëherë, vijojmë me pjesën tjetër të zhvillimit të kësaj mbledhjeje, ku anëtarët e këtij komisioni bëjnë pyetje, sigurisht edhe diskutime, në favor të këtij procesi raportimi.

Fillimisht, do të desha unë të ngre disa çështje dhe do të doja një përgjigje nga ju, pastaj do të jem si gjithmonë shumë liberal për dhjetëra pyetje, nëse mundet, nga anëtarët e këtij komisioni.

Çështja e parë që dua të ngre lidhet me fondin e prodhimeve të pavarura, pasi në faqen zyrtare nuk ka transparencë në lidhje me prodhimet që kanë fituar mbështetje financiare. Pse?

E dyta lidhet me Bordin Artistik dhe me veprimtarinë e tij. Nuk ka të dhëna as në raport, as në faqen zyrtare për veprimtarinë e këtij bordi për katër vjet radhazi, ndërkohë që ka edhe rekomandim nga Kuvendi për të rritur transparencën mbi veprimtarinë e këtij bordi.

E treta, mbaj mend se edhe në mbledhjen e vitit të kaluar, kur është bërë raportimi, kemi folur për transparencën e vetë Këshillit. Ndërkohë, nuk janë publikuar të gjitha vendimet e Këshillit për vitin 2022, po edhe kur janë publikuar vendimet, shpeshherë mungojnë relacionet përkatëse të vendimeve, që duhet të shoqërojnë gjithmonë përmbajtjen, arsyet e të tjera, apo edhe ndonjë lloj debati apo diskutimi që është bërë.

E katërta, është miratuar struktura e institucionit me vendimin e Këshillit, datë 15.3.2022, por nuk është shoqëruar me atë lidhjen përkatëse, ku është kategoria dhe paga e çdo vendi të kësaj organike.

E pesta, lidhur me rekrutimin e stafit ose edhe lirim nga përbërja e stafit, nuk ka procedura transparente, gjithmonë ka pasur ndryshime të shpeshta dhe jo gjithmonë të argumentuara. Pse ka ndodhur kjo dhe çfarë masash merren që të mos ndodhin më në të ardhmen, duke filluar që nga ky vit, pavarësisht se ne presim të emërohet edhe drejtori i ri dhe, natyrisht, të flasim edhe me të sapo të ketë filluar punë? Besoj se do ta thërrasim si komision për të na paraqitur programin dhe platformën e punës së tij.

Çështja tjetër ka lidhje me punonjësit e larguar nga Radiotelevizioni dhe pasojat negative financiare. Nuk ka të dhëna për vitin 2022. Pra, ka pasur apo nuk ka pasur, se nuk e dimë fare, se as në raport nuk ka diçka të tillë? Nëse po, çfarë do të bëhet që të mos përsëriten më? E kuptoj se kjo është një sëmundje jo vetëm e Radiotelevizionit, po edhe më gjerë, por, gjithsesi, secili sheh hallin e tij.

Çështja tjetër lidhet me raportin ekonomik-financiar për vitin 2022, i cili, gjithashtu, nuk është publikuar në faqen zyrtare, as di të ketë ardhur këtu në Kuvend.

Besoj se këto ishin çështjet për të cilat unë kisha interes, sepse edhe nga diskutimet që kemi bërë herë të tjera kemi folur shpesh për transparencë, transparencë, transparencë dhe jo vetëm si një mjet kontrolli, por edhe si një mjet vetëkontrolli. Pra, kur je i detyruar të jesh transparent, je i detyruar të jesh edhe më i vetëkontrolluar, që do të thotë edhe më i ndershëm.

Faleminderit!

Nuk e di si doni të veprojmë, të merrni të gjitha pyetjet e të gjithë kolegëve apo sipas rastit?
Si mendoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Atëherë, duam përgjigjet e pyetjeve të para dhe pastaj do të vijojmë me kolegë të tjerë, duke filluar me opozitën natyrisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili do të japë përgjigjet, të marrë fjalën, sepse nuk e përcaktojmë ne cili jep përgjigjet.

Leka Bungo – Më lejoni të shpjegoj unë pyetjet apo sugjerimet për të cilat mendoj se mund të përgjigjem, ose vërejtjeve që ka zoti Koçi.

Po e filloj nga ajo çka unë jam personalisht më afër, nga Bordi Artistik.

Bordi Artistik, është e vërtetë vërejtja që ju bëni, është me dy pamje.

Këshilli Drejtues ka dy vjet e pak që ka nisur punën e zgjedhur për të bërë veprimtarinë në Radiotelevizionin Shqiptar. Përgjatë kësaj periudhe janë tre këshilla artistike.

I pari, që ishte krejt formal, që përbëhej nga disa punonjës që nuk kishin autoritetin, personalitetin e duhur për të gjykuar për programe madhore dhe për probleme serioze e profesionale artistike të Radiotelevizionit, u eliminua dhe u përzgjedh një bord artistik i ri. Sipas gjykimit tim, ishte një këshill me personalitete, me emra, duke filluar që nga kryetari Papagjoni, ishte anëtar i Akademisë së Shkencave, kritiku më i mirë sot në pjacë profesionale, për të vazhduar me Stefan Gajon, një nga operatorët më të mëdhenj të Shqipërisë, një artist i dëgjuar; Driada Dervishi, një regjisore që sot është nga më të mirat në brezin e vet dhe dirigjenti i Orkestrës së Radios, Oleg Arapi. Këta përbënin bordin artistik, gjithmonë sipas meje. Ja ku jemi.

Unë e kam kundërshtuar dhe vazhdoj ta kundërshtoj. Unë kam shkruar shumë në shtyp për këto probleme, ju ndoshta nuk i keni lexuar, por mund t'ju them vetëm këtë, se lidhur me këtë problem, kam marrë me vete një dokument, gjë që nuk besoj se mund të ndodhë në një vend tjetër. Dokumenti thotë: “Vendim. Shkarkim nga detyra të anëtarëve të Bordit Artistik të Radiotelevizionit Shqiptar”.

“Vendosa”, thotë drejtori, pa thënë pse, pa thënë si “të shkarkoj këshillin artistik”, vendos emrat e anëtarëve të këshillit dhe është me urdhër, firmë dhe vulë të drejtorit. Për mua ky është një veprim që ...

Ka një defekt të vogël në marrëdhëniet e mia me këtë problem, se unë jam betuar të mos flas më për atë që ka qenë drejtor. Mirëpo më del përpara dhe nuk kam ç'bëj.

Tani...

Petro Koçi – Më falni, jeni i detyruar, sepse ju raportoni për veprimtarinë e vitit 2022.

Leka Bungo – Në rregull.

Petro Koçi – Nuk ka rëndësi se cili ka qenë drejtori.

Leka Bungo – Kjo është situata e tanishme lidhur me Bordin Artistik. Ky është vendim real, është këtu dhe nuk ka motiv fare pse. Drejtori nuk thotë përse e shkarkon dhe zgjedh një këshill artistik tjetër.

Tani, ky vendim është marrë në bazë të një propozimi që ka ardhur nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, por që mbulon edhe këtë sektor. Pra, ai nuk jep motiv, por tregon një hartim se çfarë ka ndodhur në një mbledhje të Këshillit Drejtues, ku anëtarët nuk kanë firmosur për filma që nuk kanë qenë të nivelit të lartë dhe nuk e kanë miratuar. Kjo kontradiktë, jua thashë, mbeti nën të dhe erdhi si përfundim shkrirja e këtij këshilli.

Nuk them se këta që janë zgjedhur nuk janë njerëz të zotë, nuk janë profesionistë, absolutisht jo, por mënyra se si u shkri ky këshill më duket deri në nota komike për sa i përket kësaj çështjeje.

Lidhur me pyetjen për transparencën, ja kjo është arsyeja, sepse ato nuk janë bërë transparente, prandaj u krijua edhe kjo kontradiktë, ky konflikt i nëndheshëm kot së koti dhe u shkri këshilli, iku ai këshill dhe erdhi një tjetër tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Bordi Artistik?

Leka Bungo – Këshilli, pra, bordi.

Petro Koçi – E mbaruam lidhur me këtë, sado që do doja të bëja disa komente në fund, por këtë duhej ta kishit raportuar ju qysh në fillim, pra rastin që sapo përmendët. Tani, jemi te pyetja për veprimtarinë e këshillit, vetë Këshillit Drejtues.

Leka Bungo – Në rregull, por unë e fillova përgjigjen me atë që thatë ju.

A folët ju për Bordin Artistik? Edhe unë u mora dhe thashë po marr këtë temë, së cilës iu drejtuat për këtë problem.

Tani, ka një gjë, që Këshilli Drejtues nuk ka kompetenca për të zgjedhur Bordin Artistik. Këtë kompetencë e ka drejtori i Përgjithshëm, por pas këtyre ngjarjeve që unë përmenda, në Këshillin Drejtues është diskutuar ky problem dhe Këshilli ka vendosur t'ia heqë të drejtën drejtorit të Përgjithshëm të zgjedhë Bordin Artistik. Këtë të drejtë ia jep vetëm Këshillit Drejtues.

Kjo është një masë, një vendim që është marrë jo më larg se dy javë më parë, pra duke u nisur nga kjo ngjarje.

Tani, zoti kryetar, unë nuk mund të përgjigjem, e para, sepse nuk kam aftësi dhe, e dyta, sepse nuk kam njohuri për gjëra që ju na informuat edhe ne, edhe komisionin. Ama, unë mendoj se kryefjala nga e cila lindin të gjitha këto është një çështje, të cilën unë e kam ngritur dy vjet më parë këtu para jush dhe do të vazhdoj ta ngre derisa të kem mundësi.

Për mua problemi kyç i Këshillit Drejtues në Radiotelevizionin Shqiptar, në mbarëvajtjen e tij, në orientimet e tij, është statuti i Radiotelevizionit Shqiptar, i cili, sipas meje gjithmonë, ky është mendim krejt personal, ka nevojë për t'u rishikuar.

Këshilli Drejtues, me ato kompetenca që i jep ky statut, është 98% noter, i cili ngre dorën për çdo propozim që vjen nga Drejtoria e Përgjithshme.

Pra, për t'ju ilustruar, kur ne erdhëm në fillim, duke u nisur nga dëshira e mirë për të bërë diçka, vendosëm në Këshillin Drejtues të ndërtonim një strukturë që nuk ishte, Departamentin e Spektaklit. Sepse nuk ka logjikë që në një televizion, sidomos në atë publik, të mos ketë departament për spektaklin artistik dhe ne vendosëm ta krijojmë këtë. Nga Drejtoria e Përgjithshme u hodh poshtë ky vendim dhe ky vendim nuk u zbatua, sepse sipas statutit është drejtori i Përgjithshëm ai që duhet të propozojë.

Pra, drejtori i Përgjithshëm, një inxhinier mekanik, më kupton, jep orientime dhe vendos për të bërë ligjin për një problem profesional, gjithnjë sipas meje!

Nëse do të kërkohet që Këshilli Drejtues të jetë aktiv dhe të gjykojë profesionalisht, duhet të ndryshojë statuti. Ndaj unë kërkohet nga ju që të na ndihmoni me asistencë juridike dhe profesionale, me mekanizmat që ju dispononi, që të bëhet një rishikim i statutit, sepse ky statut është hartuar nga drejtorë të Përgjithshëm që të kenë të gjitha atributet, të gjitha kompetencat për të zbatuar dhe për të ekzekutuar çdo gjë.

Këshilli Drejtues nuk ka të drejtë të kontrollojë.

Drejtori, sipas Statutit, duhet të raportojë një herë në muaj, ndërkohë ka ardhur vetëm një herë në vit. Por nuk e kërkon dot, sepse ka edhe një gjë, për të qenë i sigurtë, edhe ne brendapërbrenda Këshillit Drejtues, për shembull, kemi trajtuar probleme të informacionit, të mungesës së transparencës që thoni ju... Unë i kam ngritur. I kam ngritur në Këshill, i kam ngritur në shtyp, sepse Drejtoria e Përgjithshme nuk jep informacion kur e kërkoj unë. Madje më thotë: ti nuk ke të drejtë të kërkosh informacion, por duhet që Këshilli Drejtues të marrë vendim që të bëjë

pyetje. Jo unë. Dhe unë i them që edhe, sipas Kushtetutës, transparenca... Po edhe një njeri që është në rrugë, po të vijë të pyesë, je i detyruar të japësh përgjigje, përveç top sekreteve shtetërore.

Unë, kryetari i Këshillit, nuk paskam të drejtë? Unë e kam bërë këtë debat me drejtorin e Përgjithshëm, e përsëris, dhe ja ku i ke të gjithë dëshmitarë, dhe ai më ka thënë: nuk jap informacion vetëm kur pyet ti, por dua vendim të Këshillit Drejtues. Dhe unë i kam thënë: po çfarë do të bësh ti? Të jap unë përgjigje. Po në qoftë se unë dyshoj, larg qoftë, që ju vidhni, ju do të më jepni përgjigje nëse vidhni ose nuk vidhni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si? Ky është dialog i bërë, është i incizuar, është i dokumentuar, është në Këshill.

Pra, mungesa e transparencës është një nga problemet kyçe dhe kjo rrjedh nga statuti.

Unë do t'ju lutem seriozisht, nëse doni që në këtë Këshill Drejtues të bëhet një punë vërtet profesionale, të na ndihmoni, sepse është një nga pikat kyçe.

Petro Koçi – Mirë, faleminderit!

Sigurisht, kjo është një çështje parimore dhe, patjetër, edhe unë besoj që vetë Këshilli duhet të ketë më shumë pushtet kontrolli mbi ekzekutivin, që në këtë rast është Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar. Pra, raporti i pushteteve duhet të jetë më i drejtë në favor të kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Për këtë ka edhe sugjerime nga Bordi i Transmetuesve Publikë Europeanë më duket. Unë kam takuar nja dy herë përfaqësuesin e tyre dhe besoj se ka nevojë për ndërhyrje edhe në statut, ndoshta edhe në ligj, për të balancuar më mirë raportin mes pushteteve edhe te media publike, siç është Radiotelevizioni Shqiptar.

Atëherë, të vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve të tjera? Kush i ka...?

Leka Bungo – Jo, unë do të jap përgjigje edhe për një çështje tjetër që ngritët ju, sepse është një problem që më ka preokupuar, e kam ngritur edhe në shtyp, që ka të bëjë me atë që thoni ju, lidhur me emërimin dhe punësimin e njerëzve, e kuadrove në Radiotelevizion.

Ju them me përgjegjësi që ardhja e ekipit të ri para rreth një viti nuk ka zbatuar ligjin, statusin e Radiotelevizionit, i cili thotë: “Marrja në punë bëhet sipas kritereve të pranimit, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues, ku përcaktohet edhe përbërja e komisionit *ad hoc* për zgjedhjen e punonjësve”.

Të gjithë punonjësit, stafi i afërt dhe i largët i drejtorit janë emëruar jashtë këtyre komisioneve dhe unë i kam quajtur, i quaj edhe sot, të paligjshëm.

Por çfarë ka ndodhur? Pasi unë kam bërë zhurmë personalisht, e kam trajtuar në Këshillin Drejtues, e kam trajtuar edhe në shtyp, pas katër muajve kur këta zyrtarë, administratorë, kanë qenë në zyrat ku kanë firmosur e kanë dhënë urdhra, kanë dalë përpara komisionit. Por cilit komision? Atij që ka caktuar Drejtoria e Përgjithshme, jo Këshilli Drejtues, madje në kundërshtim me statutin. Ky është përsëri një nga problemet që shtruat ju, problemi i transparencës në lidhje me rekrutimin e stafit.

Kaq kisha.

Petro Koçi – Ja, ky ishte raportimi i vërtetë. Kush do ta marrë fjalën për përgjigjet e pyetjeve të tjera?

Mevlan Shanaj – Mund të shtoj diçka, apo nuk më ka ardhur radha?

Petro Koçi – Jo, domethënë, këtu janë disa pyetje...

Mevlan Shanaj – Më falni, unë e kuptoj radhën, por përderisa kemi ardhur këtu, unë do t'i them ato që...

Faleminderit!

Petro Koçi – Por e kam fjalën që kush do të përgjigjet për pyetjet e tjera?

Mevlan Shanaj – ...t'i sqaroj të gjitha, i nderuar zoti kryetar.

Dua të them...

Petro Koçi – Një sekondë, se jeni pa mikrofon, nuk regjistrohet.

Mevlan Shanaj – Unë kam zë të fuqishëm, më regjistron edhe mikrofonin juaj...

Petro Koçi – Jo, jo, ti fillimisht na shpjego formulën e rinisë së përjetshme, pastaj ato të tjerat...

Mevlan Shanaj – Atë do ta shpjegoj në sajë të burokracisë së pakorrigjueshme që ekziston edhe këtu mes jush.

I nderuar kryetar, qëllimi që ka menduar ligjkrijuesi i bordit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit është që të funksionojë si një televizion i perceptueshëm, i ndjekshëm nga audienca, sepse funksionon në sajë të taksave që paguani edhe ju.

Mirëpo këto që ngriti zoti Bungo, unë jo vetëm i kam ngritur, por unë edhe bërtas pak atje, se në këtë Këshill unë shkoj si regjisor dhe shkoj për të ndryshuar imazhin e televizionit. Madje nuk e pranoj kur miqtë e mi më thonë: “Hë, mor, ç’ke bërë ti?! Ke dy vjet atje. Çfarë po bën? Përse nuk ndryshon imazhi i televizionit?”

Sepse ne, si Këshill Drejtues, jemi thjesht firmosës të ligjit. Unë duhej të kisha mbaruar për juridik ose për financier, se vetëm shkresa të tilla firmos.

Për sa i përket drejtimit artistik, ndryshimit artistik të Radiotelevizionit, as diskutohet se mund të bëhet, sillni edhe 40 veta të tjerë. Përsëri në mënyrën se si është ndërtuar dhe konceptuar ka një burokraci të tmerrshme, e cila i jep kompetenca titullarit dhe ky i fundit është në rregull, se nuk vjen ai i auditit ta kapë, se i ka marrë firmat nga ne, që e ka bërë në rregull atë... ku e di unë, çfarë bëjnë këto, shpenzimet financiare.

Unë i firmos që të gjitha ato, sepse nuk kundërshtoj ekspertin që më la vendin këtu. Nuk mund të hyj unë në polemikë me këtë, se ai është ekspert. E solli, unë i vë firmën. Ama, në çështjet artistike unë kam të drejtë të pretendoj.

Kam kaluar jetën time për 50 e ca vjet në atë institucion dhe, kur e ndiej këtë impakt, qoftë edhe te ju... Po t'ju marr të gjithëve në pyetje unë tani, se jeni edhe të rinj, si profesor i vjetër, se çfarë raporti keni ju me Televizionin Shqiptar, ta dini që, që atje deri këtej merrni 4. Ju nuk e ndiqni Televizionin Shqiptar!

Nëse thoni që e ndiqni, më falni për ndershmërinë, por mashtroni veten, se mua nuk më mashtroni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që nuk e ndjek. Përse nuk e ndjek?! Sepse ai televizion ka humbur audiencën. Televizioni fiton personalitet me vlerat artistiko-kulturore.

Në kohën time, në atë kohë, në sforcë të tmerrshme, por ne ndiqeshim në tërë Shqipërinë, jo sepse ishim një kanal, por sepse ne vinim te çdo shikues, te çdo dëgjues. Sot konkurrenca e madhe e ka bërë Televizionin Shqiptar që të jetë më keq se i njerkes, dhe kjo është e vërteta.

Le të zemërohen këta që paguhen, drejtorë a drejtues, çfarë janë, le të zemërohen. Këta bëhen miq me mua kur ekrani fillon dhe të tërheq dhe ty, gocë, më falni, edhe juve, kur ju ta ktheni tek Televizioni Shqiptar.

Përse ndodh që Televizioni Shqiptar i ka braktisur shikuesit? Përse ndodh që prej dy vjetësh që jam unë atje (po, po, unë, unë, unë kam egon time, profesionin tim) nuk kam arritur dot të tërheq vëmendjen? Sepse ne jemi burokratë që firmosim formalitete!

Ai statuti që përmendi zoti Bungo, vetëm me televizionin nuk ka lidhje, por është bërë nga disa burokratë për t'u shërbyer qëllimeve të tyre: të jemi vigjilentë që të mos na vjedhin, se këtu

vjedhin me tendera e të tjera. Domethënë, televizioni të dalë me drejtues, të cilët janë shumë korrektë me shtetin dhe nuk kapen si hajdutë.

Pse të më interesojnë mua këto? Unë nuk merrem fare me këto, por merrem me nivelin artistik. Ai e kthen vëmendjen. Të gjithë këta që do të bëhen drejtorë kanë shpëtuar, sepse Televizioni Shqiptar nuk ka probleme politike dhe politikisht është më korrekt se gjithë të tjerët. Kjo është arritur dhe është një fitore e madhe. Të kesh një televizion publik të distancuar dhe të shkëputur nga politika, është fitore, por nuk mjafton vetëm kjo, sepse nuk është vetëm një kanal i partisë që vjen në pushtet apo i opozitës. Keni fituar një betejë shumë të madhe, që ka qenë kancer për Televizionin Publik Shqiptar: matjen e minutazhit, sa doli njëri apo tjetri, por keni shkatërruar artin dhe kulturën. Ta dini mirë që të gjithë se pa art dhe kulturë askush nuk të hedh sytë.

Informacioni politik merret edhe në radio apo mjetet elektronike që kanë dalë tani. Fakti që Televizioni Shqiptar nuk po kthehet te spektakli, te filmi, te drama dhe te problemet sociale, është një alarm për mua. Po t'i merrni të dhënat, do të dalë që këtë muaj janë trajtuar shkëlqyeshëm të gjitha problemet sociale, por matja është sa shikues të ndjekin.

Në fund kam një vërejtje për ju. Një vit më përpara na ka ikur i ndjeri Petrit Ruka dhe prej një viti ju nuk e zëvendësoni. Çfarë ju pengon, i nderuar kryetar, që nuk sillni një anëtar të Këshillit Drejtues? Është indiferenca juaj dhe si ju ka shumë indiferentë në Shqipëri.

Për t'ju kthyer përgjigje juve, unë do të mbetem ende i ri, sepse nuk rri dot indiferent.

Faleminderit!

Petro Koçi - Faleminderit!

Ka përgjigje të tjera?

Knidi Bashari - Unë jam Knidi Bashari, kryetar i Bordit të Administrimit në RTSH. Dua të bëj një ndërhyrje në lidhje me fondin e prodhimit të pavarur. Nuk mund të them pse nuk është realizuar nga ana menaxheriale, por nga ana buxhetore mund t'ju jap një sqarim. Parashikimi për vitin 2021 ka qenë 15 milionë lekë, kurse për vitin 2022 parashikimi ka qenë 10 milionë lekë dhe nuk është realizuar, kjo për arsye se ndoshta projektet që kanë ardhur nuk kanë qenë në nivelin e pritshmërive që ky fond të shpenzohej, ndërkohë që janë marrë masat që ky fond të trashëgohej. Pra, lekët që nuk u shpenzuan në vitin 2022 do të shpenzohet në vitin 2023. Nga pikëpamja buxhetore, nga ky fond janë parashikuar 22 milionë lekë për t'u shpenzuar në vitin 2023. Kjo ishte ajo që mund të thosha unë për fondin e prodhimit pavarur.

Leka Bungo – Më falni, se ndoshta po flas shumë, por dua të flas edhe për një problem shumë të madh që ka të bëjë me këtë që u tha. Në faturën e energjisë elektrike që OSHEE-ja shpërndan është e përfshirë edhe fatura e pagesës për aparatet televizive, e cila është 100 lekë. OSHEE-ja mban 10% të totalit të parave që ne mbledhim. Pse i mban këto para, se shton në fund të shkresës edhe një fjali? E kemi ngritur këtë shqetësim disa herë me radhë, por nuk na ndihmon njeri. Është gjynah, se me ato 10%, që duken shumë qesharake, bëhen 3 spektakle artistike në vit. Le të mbajnë 2%, por të mbajnë 10% vetëm se në shkresën e tyre shtojnë edhe këtë fjali, është shumë.

Më shumë se ju, kurrkush nuk mund të ndërhyjë për të zgjidhur një problem të tillë. Kur administrata kërkon para, duket sikur janë të pangopur, kurse ne nuk kemi një studio. Të flasim me këmbë në tokë, jo të bëjmë hartime këtu. Radiotelevizioni Shqiptar nuk ka studio, ndërkohë që edhe televizionet më ordinere në Shqipëri kanë studio.

Pas 6 vjetësh luftë u morr atelieja në Kinostudio, një ambient fantastik 1200 metra katrorë, por nuk ka para për ta kthyer në studio. Ky është krim. Ka 6 vjet që ky ambient rri kot, ndërkohë që ne shkojmë në Kinostudio dhe paguajmë qira për të bërë spektaklet. Pra, paguajmë qira, ndërkohë që kemi studiot tona. Paratë ikin për qira studioje, jo për spektaklin. Ky është mëkat. Ne nuk kemi fuqi t'i bëjmë këto as si Këshill Drejtues, as si Drejtori e Përgjithshme, por dikush duhet të ndërhyjë, që të na ndihmojë për këto. Këto janë çështje kardinale, nuk janë çështje që zgjidhen me një bisedë.

Petro Koçi - Për komisionin që mban OSHEE-ja ne duhet t'i drejtohem zyrtarisht Komisionit të Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ta shikojmë bashkë me ta.

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, zoti Koçi!

Në traditën e këtij komisioni, këtë e them jo për të sulmuar, por thjesht për ta ditur, është bërë zakon që drejtuesi i komisionit e merr kohën kryesisht për të folur vetë, duke mos bërë rolin e moderatorit. Pra, mbaron njëherë çfarë ka për të thënë vetë dhe pastaj ua jep fjalën anëtarëve të tjerë. Nuk është vetëm për ju, zoti Koçi, por për këdo që e ka drejtuar këtë komision.

Për sa i përket Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, në fakt, ishte propozimi imi që këtu të ishin të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues për shkak të një letre zyrtare me nr. prot.

1335, datë 14.4.2023, drejtuar këtij komisioni për njohjen me një konflikt interesi të një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar në funksionet e tij si anëtar.

Ne debatuar këtu dhe u mbajtën disa qëndrime: disa e konsideronin letër anonime, të pavërtetë, kurse unë kisha qëndrimin tim, që personi të ishte vetë këtu për ta sqaruar. Pra, një nga arsyet që unë ftova të gjithë anëtarët e Këshillit ishte që ne të mos abuzonim me konkluzione nisura nga një letër apo nga një informacion, por të pyesim anëtarin e Këshillit Drejtues në vetë të parë në komision si është situata në lidhje me të dhe është e vërtetë kjo apo jo.

Unë mendoj se çdo njeri ka të drejtën e tij për të dhënë argumentet, nëse është në konflikt interesi apo jo dhe, më pas, ky komision të marrë të gjitha prerogativat që i cakton ligji.

Unë konstatoj që zotëria nuk ka ardhur. Nuk e di arsyen, por ndoshta mund të na e sqarojë stafi i komisionit ose drejtuesi i komisionit çfarë përgjigje i ka ardhur apo edhe kryetari i Këshillit, nëse ka marrë një përgjigje pse nuk është i pranishëm zoti Podgorica, që, në dijeninë time, ka edhe funksionin e nënkryetarit të Këshillit Drejtues. Unë mendoj që, përderisa nuk e kemi sot të pranishëm, ne mund t'i dërgojmë një shkresë në mënyrë që të marrim një përgjigje me shkrim. Megjithatë, nëse ju keni ndonjë informacion, mund ta ndani me ne. E them këtë për të kuptuar që ligjshmëria është një pikë shumë e rëndësishme për Këshillin Drejtues, për drejtorin, por edhe për veprimtarinë e Radiotelevizionit.

Në goftë se ligjshmërinë nuk e filloni në radhë të parë te vetja juaj, është shumë e vështirë që më pas ta kërkonte tek të tjerët.

Të gjithë anëtarët që janë sot këtu do të duhet të thonë me përgjegjësinë e tyre që nuk kanë konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tyre si anëtarë të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Në këtë mënyrë çlirohen edhe ata nga kjo barrë, por edhe ne fillojmë një kapitull të ri besimi me njëri-tjetrin. Kjo ishte çështja e parë për të cilën doja të flisja.

Çështja e dytë ka të njëjtën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ju janë pyetjet, por ta mbaroj të gjithë mendimin dhe pastaj ju do të keni të gjithë kohën që ju nevojitet për t'u përgjigjur.

Në të njëjtën logjikë, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar ka një kompetencë të jashtëzakonshme. Unë jam dakord me ç'dolloj fjale që tha zoti Shanaj, por edhe ju, për problematikat, për statutin, e të tjera, por ju keni kompetencën më të madhe: ju zgjidhni drejtorin. Drejtorin nuk jua ka dhënë njeri, e keni zgjedhur vetë. Ju keni zgjedhur drejtorë, për të cilët më pas

jeni bërë pishman. Ju sapo keni hapur garën e radhës. A është e mundur që në garën e radhës minimalisht të respektoni ligjin, ato që kërkon ligjin, të mos e politizoni Radiotelevizionin Shqiptar, të bëni atë që tha zoti Shanaj, të distancoheni nga politika, të zbatoni nenin 104 të ligjit nr.97/2013, që i ndalon çdo anëtar i partie, çdo ish-deputeti dhe çdo njeriu që merret me politikë për t'u zgjedhur në krye të Radiotelevizionit Shqiptar, në mënyrë që pas një viti ju dhe ne të mos kemi përplasje me drejtorin e ri? Një njeri, kushdoqoftë, që vjen në mënyrë të paligjshme, të jeni të sigurtë që me të njëjtën mënyrë të paligjshme do të qeverisë, sepse nuk do t'ju detyrohet ju, por atij që realisht e ka vënë aty.

Unë nuk dua të flas sot me emra, por dua të flas në parim. Parimi është që të shmangim çdo shkelje të ligjit, çdo konflikt interesi, edhe kur vjen për anëtarët e Këshillit, edhe kur vjen për zgjedhjen e drejtorit, por edhe kur vjen për ushtrimin e kompetencave të drejtorit nesër. Është shumë e domosdoshme që ne të jemi në krahun tuaj, në mënyrë që edhe ju të jeni në krahun e ligjit. Bashkë e bëjmë betejën shumë më kollaj.

Të jeni të sigurt që unë personalisht kam arritur të mbledh firmat e deputetëve edhe për çështje që deputetët kanë pasur vendim grupi për të mos votuar. Ua kam marr firmat në bazë të drejtësisë, të parimit dhe kam shkuar edhe në Gjykatën Kushtetuese. Unë e ndjek betejën në çdo gjykatë, në Gjykatë Administrative, në Gjykatë Kushtetuese, përkrah secilit prej jush, nuk ju lë në baltë, në parlament, me çdo instrument, por ama po të jeni edhe ju në krahun tim dhe të jemi të gjithë në anën e ligjit dhe të së drejtës dhe jo ta shkelim njëherë se na detyron Kryeministri, iksi apo ypsiloni dhe pastaj ta kërkojmë për herët e tjera, sepse bëhet shumë e vështirë dhe nuk ia arrijmë dot.

Ne kemi zgjedhur një anëtar tjetër të Këshillit Drejtues dhe zoti Shanaj përsëri ka të drejtë. Është e pafalshme që ky komision të ketë votuar dhe të ketë zgjedhur një personalitet të nderuar, siç është zoti Ndriçim Xhepa, dhe të mos e kalojmë në seancë për harresë, përtesë apo për ndonjë puç të radhës, siç iu bë një anëtar i pak më parë, të cilin e zgjodhëm, e çuam në seancë, e detyruan të tërhiqej dhe pastaj e detyruan të rikandidonte përsëri. Këto lojëra nuk janë të drejta dhe mua nuk më pëlqejnë.

Përfitoj nga rasti që jeni këtu për t'u bërë thirrje anëtarëve të mazhorancës, që nesër, kur është seanca e radhës e parlamentit, ne ta votojmë zotin Ndriçim Xhepa. Edhe pse përfaqëson vend vakance të mazhorancës dhe unë jam pjesë e opozitës, e deklaroj që zotin Ndriçim Xhepa do ta

votoj. Është personalitet. Nuk kam komplekse kur propozimi është për të votuar një personalitet që vjen nga mazhoranca, sepse vakanca iu krijua atyre.

Këshilli Drejtues, po ashtu, ka një problem që sot nuk përfaqëson raportet që duhet të kishte mazhoranca dhe opozita. Nga 10 anëtarë, vetëm 1 anëtar është propozuar nga opozita. Sigurisht, prishja e kësaj balance do të sjellë edhe prishje të balancave të tjera në argumentet që do të ndodhin më vonë edhe brenda Këshillit, edhe në vendimmarrjen e Këshillit.

Ju ngritët me të drejtë shumë probleme që i ngre edhe raporti i monitorimit të institucioneve, por unë besoj se të gjitha këto probleme, që nga gjuha e shenjave, transparenca, programet për fëmijë, RTSH Kuvendi, e të tjera, janë minore në krahasim me frymën, me drejtimin, me statutin dhe me ligjshmërinë, se nëse arrihen këto, këto të tjerat zgjidhen për jo më shumë se dy muaj, sepse krijohet klima e besimit dhe e bashkëpunimit.

Në këtë aspekt, unë nuk do t'i prek fare këto problematika, strukturën organizative të institucionit që ndryshon herë pas here, punësimet, gjyqet që kanë shkuar për pushime të parregullta e të tjera, jo se nuk janë, sepse janë, por janë rezultat i frymës së paligjshmërisë që ka ekzistuar në Radiotelevizionin Shqiptar.

Kështu që, unë do të doja nga ju si kryetar i Këshillit, si garant i ligjshmërisë dhe si një person për të cilin realisht kam vlerësim, por edhe nga anëtarët e Këshillit Drejtues, raportin me ligjshmërinë për sa u përket zgjedhjeve të ardhshme që keni. Keni vendosur afat datën 8. Data 8 erdhi. Do të zbatoni ligjin apo do të dëgjoni Maliqin?

Kaq kisha.

Petro Koçi - Zoti Bungo, dëgjova që doni të bëni një reagim.

Leka Bungo - Kjo ka të bëjë me mua. Përpara disa kohësh, në datën 14.04.2023 unë i kam dërguar Kuvendit të Shqipërisë, kryetares së komisionit, zonjës Flutura Aça, një letër, e cila nuk është anonime, por ka emrin dhe firmën e Leka Bungos, ka vulë dhe është e protokolluar. Kjo është bërë në bazë të ligjit.

Në ligj unë detyrohem që brenda 5 ditëve të njoftoj Kuvendin e Shqipërisë, në qoftë se konstatohet konflikt interesi dhe unë e kam bërë këtë gjë.

Kjo është letra ime drejtuar zonjës Flutura.

“Unë personalisht e kam ditur se Gëzim Podgorica ka qenë dhe është përgjegjës i Agjencisë Mediatike Kineze në Tiranë, por nuk kam pasur dijeni që këtë e pengon ligji dhe nuk jam ndjerë, por kur lexova ligjin e mësipërm, më lindën dyshime. Prandaj, meqenëse ligji, neni

100, pika 5, thotë se kur konstatohet njëri nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryetari i Këshillit Drejtues, brenda 5 ditëve njofton me shkrim Kuvendin.

Shqyrtimi i një çështjeje të kësaj natyre nuk i takon Këshillit Drejtues, prandaj, nisur nga sa më sipër, po ju informoj për dyshimet që kanë lindur, që Kuvendi të gjykojë lidhur me të. Bashkëngjitur do të gjeni edhe këtë letër që ka sinjalizim”.

Kjo është letra që unë kam dërguar. Kjo është një çështje që ju takon juve, i takon komisionit, Kuvendit, jo neve. Sipas ligjit, unë jam i detyruar të njoftoj Kuvendin.

Kaq kisha.

Petro Koçi - Letra ka ardhur, por bashkëngjitur kishte një letër tjetër, nga e cila ishit nisur ju që na keni nisur neve, shkresë, e cila ishte e pafirmosur dhe poshtë lexonte: “Prefekti”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Letra nga e cila ju ishit nisur ishte anonime. Është njësoj si shprehja: “një njeri që të do të mirën”.

Gjithsesi, ky moment përbënte arsye që ne ta shqyrtonim çështjen. I kemi kërkuar pjesës ekzekutive të Kuvendit ta këqyrë problemin dhe nëse ka një konkluzion, sigurisht që ne do të reagojmë jo vetëm si komision, sepse kjo është një çështje përtej komisionit, por me nismën e komisionit, sepse pastaj vendos Kuvendi çfarë do të bëjë, jo komisioni.

Kështu që, ne presim që Drejtoria e Monitorimit në Kuvend ta shqyrtojë çështjen, të bisedojë edhe me personin përkatës dhe pastaj ne do të pozicionohemi. Në rast se ka konflikt interesi...

Kur është bërë zgjedhja, është deklaruar që nuk ka konflikt interesi. Ne nuk kemi qenë në Kuvend atëherë, të paktën unë nuk kam qenë, sepse ndonjë tjetër mund të ketë qenë, por atëherë Kuvendi ka vepruar në përputhje me ligjin, sepse nuk ka ekzistuar konflikti i interesit. Meqë tani ka lindur dyshimi se ka konflikt interesi, do të shikohet dhe, natyrisht, që do të reagohet.

Kush tjetër ka diçka për të thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbaroni pyetjet.

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Unë i mbarova pyetjet, sepse i bëra më shumë parimore dhe konceptuale sesa me detaje, por dua një përgjigje nga anëtarët e Këshillit dhe nga kryetari i Këshillit. Përpara keni procesin e zgjedhjes së drejtorit të ri. A do ta zbatoni ligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, dua ta dëgjoj.

Zoti Bungo, dua që ju sot, ndryshe nga mënyra kur e votoni atje, të merrni angazhim para mediave që nuk do ta dhuroni Radiotelevizionin Shqiptar si qokë politike dhe nuk do të shkelni ligjin, nuk do të shkelni nenin 104 të ligjit, që i ndalon ish-deputetët dhe anëtarët e partisë, cilado parti të jetë, Demokratike apo Socialiste, të jenë drejtorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leka Bungo - Unë ju siguroj, në emër të anëtarëve të Këshillit...

Petro Koçi - Zoti Bungo, se jua hoqa unë mikrofonin. Edhe një herë.

Një sekondë, se e drejtoj unë mbledhjen, për fat të keq.

E kam fjalën këtu: duket që pyetja është jashtë një formati etik, sepse këtu ju nuk jeni nxënës dhe ne nuk jemi mësuesit tuaj, që t'ju pyesim, a do e zbatoni ligjin, apo jo? Sigurisht, nëse nga përbërja politike e komisionit ka dyshime që mund të ketë ndonjë veprim apo akt që nuk përputhet me ligjin, atëherë mendoj se tërheqja e vëmendjes mjafton.

Pra, ne si komision, që të gjithë, pa dallim partie, kërkojmë që në çdo proces të veprimtarisë së Këshillit të zbatohet ligji pikë për pikë. Kaq. Nuk është etike t'ju them unë juve: Zoti Bungo, do e zbaton ju ligjin? Nuk shkon, se nuk na takon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e dëgjova përgjigjen, ishte sa artistike, aq edhe e mençur.

Po, zonja Zhupa sërish.

Ina Zhupa – Zoti Koçi, faleminderit për sugjerimet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, unë kam informacion.

Sigurisht që kam informacion dhe besoj që edhe një pjesë e juaja ka informacion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë thashë “një pjesë”, sepse dua të jem korrekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendoj që ndoshta mund të ketë informacion, por nuk e di, nuk dua të atakoj asnjë. Sinqerisht pyetja ime vjen dashamirëse për vlerësimin që kam për personalitet që janë brenda Këshillit Drejtues. Unë e thashë edhe një herë, brenda Këshillit Drejtues ne kemi një handikap të madh, pasi nuk kemi përfaqësimin që duhet të kishte opozita sipas ligjit, edhe për fajin tonë të vitit

2019, ku opozitë u trajtuan disa deputetë të cilët nuk ishin opozita reale e vendit. Megjithatë, unë nuk dua t'i hyj kësaj çështjeje. Pyetja ishte si indicie e asaj që u tha se kur u zgjodh zoti Podgorica, ne nuk e dinim ligjin, nuk e dinim që kjo ishte një shkelje e ligjit. Atëherë, nëse zgjidhet një Alfred apo tjetër, mos ne nuk e dimë përsëri që është shkelje ligji dhe e kujtojmë më vonë?! Mirë do të ishte ta dinim që tani se çfarë përbën shkelje ose jo. Po ashtu, nëse doni, mund të na kërkoni neve mendim juridik dhe ne, si komision, mund t'ju japim një raport me kushtet e papajtueshmërisë së pozicionit të drejtorit të Përgjithshëm, për të ditur se kush mund të ketë mundësi të kandidojë dhe kush nuk mund të ketë mundësi. Ne jemi të gatshëm si komision, jo pjesa politike, por pjesa e stafit të Kuvendit, pjesa e njerëzve që paguhen si këshilltarë ligjorë, që t'ju japim këtë informacion, me qëllim që në zgjedhjet e ardhshme të mos bëni shkelje ligjore, të cilat mund të jenë të ndikuara politikisht ose jo, ose mund të jenë thjesht nga padija e ligjit në një moment të caktuar, sepse shumica janë artistë. Sigurisht, edhe ne nuk duhet të kemi 100% njohuri si nga pjesa e financës, siç e tha me të drejtë zoti Shanaj, kur firmos nuk mund të ketë 100% njohuri nga pjesa e kontabilitetit, e financës, e pjesës juridike apo e pjesës menaxheriale. Për këtë arsye ishte edhe pyetja ime. Nuk ishte as për t'u atakuar, as për t'ju thënë diçka, por ishte për shkak të një indicie që unë kam dhe për shkak të faktit që t'ju ofrojmë ndihmë, që ju të merrni një vendimmarrje sa më konstruktive, që nesër t'ju shërbejë në punën tuaj, që nesër të keni një drejtor apo një drejtoreshë, sepse flasim gjithmonë “drejtor” në mashkullore, por mund të jetë edhe një drejtoreshë, e cila mund të bashkëpunojë shumë mirë dhe më këndshëm me zotin Leka dhe me gjithë Këshillin Drejtues. Shikojeni edhe këtë si prioritet, që t'i jepni një fytyrë femërore Radiotelevizionit Shqiptar, sepse do të ishte e këndshme.

Faleminderit!

Petro Koçi - Jam i bindur që Këshilli nuk pranon asnjë lloj presioni nga jashtë.

Zoti Spaho.

Florenc Spaho – Faleminderit!

Në fakt, duke qenë se i gjithë Këshilli Drejtues është këtu, do të ishte e udhës që të nxjerrim disa pika, se po flasim vetëm për opinione, por jo për pika ku të bazohemi, pikërisht për raportin që na ka ardhur edhe nga kryetari i Këshillit Drejtues, nga zoti Bungo. Duke iu referuar edhe pikave që unë i citova në relacion nga rekomandimet e Shërbimit të Monitorimit, së pari, dua të them se janë shumë kanale dedikuar RTSH-së, të cilat nuk janë cilësore.

Kam një pyetje për të gjithë anëtarët dhe për të gjithë të pranishmit që na kanë nderuar sot këtu. Gjithë këto kanale të Radiotelevizionit Shqiptar, RTSH Shkolla, RTSH Fëmijë, RTSH Kuvendi e të tjera, nuk janë në cilësinë e duhur, siç e cilësoi edhe zoti Shanaj, në fakt, që ndoshta me shumë të drejtë jep opinione për sa i përket mirëfunksionimit.

Unë kam qenë edhe në mandatin e kaluar dhe kur vijnë emra të tillë si ai i zotit Shanaj dhe kolegëve të tjerë për t'u votuar, për t'u bërë pjesë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, duke qenë se janë artistë, kanë shpirt luftaraku. Patjetër, për të qenë anëtar i këtij Këshilli të nderuar, terreni ku ata punojnë nuk është aspak i lehtë dhe me të drejtë kërkojnë kushte më të mira, por dhe të drejtojnë gishtin për të bërë më shumë. Pra, kanë qenë dakord të gjithë, apo ka qenë vetëm propozimi i drejtorit të atëhershëm, që të hapeshin kaq kanale televizive, të cilat nuk e kanë cilësinë e duhur dhe audiencën që i duhet Radiotelevizionit Shqiptar? Ky televizion për të gjithë ne shqiptarët është aset kombëtar; edhe për njerëzit e moshës sime, edhe për njerëzit në moshën e prindërve të mi është nostalgji, pasi ne jemi rritur me këtë televizion, me figurat, me profesionistët që kanë punuar në këtë televizion, në botën e artit, në lajme, në kronika dhe në të tjerat me radhë.

Te pjesa e rekomandimeve, siç e thashë, për kanalin RTSH Fëmijë, unë nuk e di se çfarë paraqet ky kanal televiziv, por kam një pyetje të drejtpërdrejtë për zëvendës drejtorin apo drejtorin artistik të Programacionit: sa nga këto emisione i përkasin shëndetit, të ushqyerit shëndetshëm dhe marrjes me sport? Përderisa themi RTSH Fëmijë, mendoj se ky është një kanal dedikuar fëmijëve në shumë dimensione, qoftë në pjesën artistike, qoftë në pjesën kulturore, qoftë në pjesën e të ushqyerit, qoftë në pjesën e të marrit me sport apo të mirëmbajtjes së trupit. Sa shikueshmëri ka në qoftë se ne nuk arrijmë t'i japim audiencës atë çfarë kërkon?

E dyta, në lidhje me Drejtorinë e Shitjes dhe të Promocionit, që është edhe burimi i tretë i të ardhurave për Radiotelevizionit Shqiptar, sa nga këto të ardhura janë të dedikuara rikthimit dhe imputit që kërkon ky Televizion? Se nuk janë pak të ardhura, vetëm për periudhën prill - dhjetor 2022 në raportin që kemi janë 50,3 milionë lekë, nuk janë të ardhura të vogla.

E treta, shpeshherë është thënë që ky televizion meriton kushte më të mira, siç tha edhe kryetari që nuk keni skena, nuk keni ku të bëni emisionet, absolutisht që duhet investuar. Për anëtarët e Këshillit Drejtues, a e ndieni veten pak përgjegjës për afrimin, qoftë të drejtorit, qoftë të personelit në Radiotelevizionin Shqiptar? Sepse shpesh ne mendojmë se infrastruktura dhe fasada mund ta thithë audiencën në televizion, ndërkohë për mua është e kundërta. Edhe para viteve 90 nuk ka pasur televizion tjetër, ne jemi rritur me performancën e të gjithë artistëve të

Radiotelevizion Shqiptar. Unë mendoj se atë televizion e bëjnë njerëzit, edhe pse infrastruktura është një pikë shumë e rëndësishme. Afrimi i njerëzve patjetër që nuk vjen vetëm me frymë dhe dashamirësinë, qoftë të zonjës Zhupa apo të të gjithë komisionit këtu, por vjen me një buxhet.

Unë e kam thënë edhe vitin e kaluar, jam i mendimit që më mirë 5 veta, por që përçojnë frymë dhe dinë të bëjnë televizion, sesa 500 veta, që për fat të keq, edhe nga ju thuhet që nuk meriton të quhet “televizion”

Faleminderit!

Petro Koçi – Kush do të përgjigjet?

Duhet të afroheni afër një mikrofoni.

Për efekt regjistrimi mund të prezantoheni.

Melsi Qirici - Përshëndetje!

Unë jam Melsi Qirici, drejtuese e Njësisë së Programeve. Kam thujse një vit që e ushtroj këtë detyrë si e komanduar. Është hera e dytë që jemi bashkë dhe unë ju falënderoj për mundësinë që na jepet për të folur, qoftë për problematikat tona, qoftë për të gjitha sugjerimet tuaja, të cilat ne përpiqemi maksimalisht t’i realizojmë.

Referuar çka u fol për pjesën e programeve, dua të sqaroj disa gjërave, duke filluar nga numri i lartë i kanaleve, për të cilat me të drejtë zotëria tha se duhet të justifikohen me cilësi. Në fakt, hapja e platformës që tashmë është e gjerë, qoftë radio, qoftë televizive i takon një strategjie të kaluar. Ne kemi kërkuar herë pas here, të paktën prej kohës që jam unë në këtë njësi, kemi bërë edhe kërkesë pranë Këshillit Drejtues për uljen e numrit të kanaleve, por të gjithë anëtarët e këshillit ose një pjesë e tyre nuk kanë qenë dakord për mbylljen e tyre dhe me të drejtë. Njësia e programeve e ka shumë të vështirë të mbushë me programacion gjithë atë platformë të madhe, se ne nuk jemi Rai, nuk kemi as buxhetin dhe as kapacitetet për t’i mbushur këto kanale me programe cilësore.

Për shembull, ne donim që RTSH Shkollë dhe RTSH Fëmijë t’i shkrinim në një kanal të vetëm, me idenë për të rritur cilësinë, por anëtarët u shprehën që RTSH Shkollë duhet të jetë si kanal i dedikuar, pasi edhe gjatë pandemisë ne kemi bërë një luftë të madhe për ta mbajtur vetëm me leksione. Kjo ka qenë një strategji e mirë që funksionoi, e cila u shërbeu edhe nxënësve, edhe mësuesve. Tani, për ta mbajtur atë kanal është e vështirë, sepse duhen buxhete, duhet infrastrukturë. Dikur në RTSH janë bërë konkurse në rang kombëtar, besoj ju duhet ta mbani mend, të cilat duan infrastrukturë dhe investim shumë të madh, mundësi që ne nuk i kemi.

Përveç asaj që tha edhe kryetari, studiot, kapacitet e skenografisë, ne nuk i kemi, teknologjinë jo e jo dhe dalim tek ajo që ju e nënvizuat me të drejtë, që kualiteti i programeve vjen duke rënë. Por më vjen keq që nuk nënvizohet asnjëherë përpjekja që është bërë për atë çka është ofruar. Për shembull, në RTSH Shkollë, për herë të parë kemi realizuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, 13 episode për konkursin e Gjuhës Shqipe për klasat e 9-ta. Kjo gjë kishte shumë vite që nuk realizohej në Televizion publik. Është bërë një marrëveshje mes dy palëve, një marrëveshje 5-vjeçare me Ministrinë e Arsimit, e cila filloi në kohën e pandemisë dhe vijon, në mos gaboj, deri në vitin 2025, dhe për herë të parë u realizua një konkurs në rang kombëtar me të gjitha klasat e 9-ta, ku u shpall edhe një fituese, madje kemi pasur edhe të ftuar nga Ministria e Arsimit në programet tona.

Te kanali i dedikuar RTSH Fëmijë ne kemi programe, por edhe në Radio te kanali i dedikuar për fëmijë ne kemi programe. Pra, programet nuk mungojnë. Janë bërë disa përpjekje që duhet thënë janë shumë cilësore për të rritur dhe për të afruar fëmijët. Ne kemi një program çdo javë me Bledin, që quhet “Luaj me mua”, i cili transmetohet çdo të diele në orën 10:20 dhe nga të dhënat që ne marrim për shikueshmërinë, është nga më të ndjekurit. Në këtë emision ftohen psikologë, mjekë, njerëz të fushave të ndryshme për të shpalosur historitë e suksesit dhe kjo hyn te pjesa edukuese e fëmijëve. Pra, mundohemi gjithmonë që fëmijët të jenë prezent, sikundër dhe të rinjtë. Ajo që ju thatë është shumë e vlefshme, por ne vit pas viti kërkojmë aplikantë për programe për të rinjtë, të cilat kërkojnë, gjithashtu, infrastrukturë dhe buxhete që nuk i kemi. Në fund të qershorit ne do të rihapim thirrjen për projekte, njoftimin publik dhe besoj se nga shtatori do të arrijmë të realizojmë një emision për të rinj, në qoftë se studiot aktuale do të na e krijojnë mundësinë, pasi siç e dini, të rinjtë tani janë të angazhuar në jetën publike, të folurit në publik është bërë shumë aktiv, ata kërkojnë studio të mëdha, kërkojnë salla universitetesh, kërkojnë shumë kamera, që teknikisht ne nuk u përgjigjemi dot gjithmonë. RTSH-ja është konceptuar si një kanal dhe jo si një platformë, kur u mendua. Pra, teknologjia nuk u përgjigjet të gjitha nevojave që kemi ne. Megjithatë, gjatë gjithë kohës jemi duke tentuar për të bërë ndryshime.

Petro Koçi – Po, faleminderit drejtoresha!

Sigurisht, shtimi i numrit të kanaleve është perceptuar si një arritje, pavarësisht diferencës midis konceptit paraprak të Televizionit Shqiptar si një kanal i vetëm dhe tani me shumë kanale, por duke vlerësuar hapat që janë bërë përpara, unë do të sugjeroja që formulat e bashkëpunimit, siç është rasti i RSHT Shkollë me Ministrinë e Arsimit apo i atij kanalit për bujqësinë, që mund në jetë

në bashkëpunim më të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, mund të zgjerohen ndoshta me Ministrinë e Kulturës për programe kulturore apo edhe me ministri të tjera.

Melsi Qirici - Është propozuar për t'u mbyllur kryetar.

Më fal për ndërhyrjen!

RTSH Agro me vendim të Këshillit Drejtues u propozua të mbyllet, ngaqë nuk ka produkte televizive. Ne po presim nga AMA një *feedback* që edhe ne ta implementojmë në vijimësi teknikisht.

Petro Koçi – Gjithsesi, e kam fjalën për formula bashkëpunimi, të cilat mund të ishin një burim kapacitetesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kanali RTSH Shkollë, që unë mburra nuk është mbyllur dhe ka qenë jetik për vitin shkollor, i cili iu nënshtrua një pandemie që ishte vdekjeprurëse për arsimin, në radhë të parë, për arsimin.

Kanalin RTSH Agro unë e vlerësoj, sepse më pëlqen bujqësia dhe natyra. Që është mbyllur, personalisht nuk më vjen mirë, por kjo s'ka rëndësi, s'ka lidhje me kënaqësitë e mia televizive.

Zoti Spaho, çfarë kishit?

Pastaj e ka fjalën zonjusha Ulliri.

Florenc Spaho - Nuk e di e ka tagrin drejtoresha apo jo, por dua të bëj një ndërhyrje për drejtoreshën e Programacionit. Radiotelevizioni Shqiptar ka programacione për të rinjtë, adoleshentët apo edhe studentët, është një televizion si gjithë të tjerët. Për të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, për të gjithë anëtarët e Komisionit ky televizion është aset kombëtar, por unë mendoj që do edhe pak shpirt patriotizmi, ndoshta nuk është fjala e duhur, për ta mbajtur këtë televizion.

Ndjesë, nuk e di e kujt është detyra, por ne kemi studentë shumë të mirë në universitetet tona që i përkasin gazetarisë, por edhe fushës së artit, që mund t'i bëni pjesë të Televizionit. Unë kam kontakt me studentët, si një person që jap edhe mësim në universitet, por studentët po t'i afrosh dhe t'i bësh pjesë me emra të tillë si Bungo, Keko, Shanaj, Tullumani, Reçi, Ndocaj, Selimi, Mici, që kanë dhënë shpirtin gjithë këto vite, jo vetëm për Televizionin Shqiptar, por të gjithë publikun, të jeni të bindur që do të përfitojnë nga fryma dhe do të bëjnë edhe për Televizionin. Unë

e di, ka njerëz që punojnë në televizione private të cilët paguhen shumë herë më shumë dhe patjetër nuk mund të ofrohen, por mund të rrisim kapacitete.

Unë kam qenë në Komisionin e Shëndetësisë mandatin e kaluar dhe të njëjtën gjë po jua them edhe juve, nuk e di e kujt është përgjegjësia për ta bërë këtë gjë ose iniciativë. Ne kemi kaluar një vit pandemik në vitin 2020, emra që mbajtën përgjegjësinë e pandemisë, profesorë të nderuar që pas 20 vjetësh, Zoti na ruajtët mos rëntë më kjo pandemi, por nuk do t'i kemi. Është e njëjta gjë sot edhe në televizion, duhet të punojmë me të rinjtë, që të prodhojmë, jo vetëm njerëz për të cilët rëndomë ndoshta në Radiotelevizionin Shqiptar mund të jenë bërë edhe qoka dhe sot themi: “Nuk kemi programacion”. Unë jam rritur me “Maratonën rinore” atij brezi i përkas. Kur fillonte “Maratona inore” në Radiotelevizionin Shqiptar për të rinjtë, aty e mbanim gjithë kohës televizorin. Festivali kombëtar prodhonte dhe nxirrte talente, aty e mbanim televizorin. Patjetër që këngëtarët kanë një rol kyç, por regjisori, scenografia dhe të gjithë producentët e bënin atraktiv. Kështu që, nëse ne nuk do të kemi shpirt, ky aset kombëtar do të shihet si të gjitha televizionet e tjera, që në një moment ka një kurbë zhvillimi, pastaj edhe një kurbë dështimi. Ne nuk duhet të pranojmë gjithsesi që për këtë televizion që ka rritur qindra artistë, gazetarë, profesionistë, sot të diskutohet kjo gjë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Zonjushë Ulliri, fjala për ju.

Andia Ulliri – Faleminderit!

Së pari, dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së, që u bënë pjesë e këtij takimi. Mendoj se pjesëmarrja juaj i shton vlerë këtij takimi, sepse mund të diskutojmë dhe mund të japim edhe ne perspektivat ose idetë tona për veprimtarinë e RTSH-së. Ne e dimë që media luan një rol shumë të rëndësishëm dhe sidomos në vende të vogla si ky i yni, patjetër që televizionet luajnë rolin më të rëndësishëm, sepse janë ndonjëherë burimi, vendi i duhur për të marrë informacionin, i cili nuk do të ishte një lajm i rremë. Në këtë aspekt mediat publike janë edhe në pozicionin kryesor për të përforcuar edukimin mediatik dhe duke rënë dakord me dy kolegët e mi, e sidomos edhe me zonjën Zhupa, për çfarë u tha më parë, dua të theksoj se çështjet e evidentuara në raportin e vlerësimit për raportin tuaj, janë disa çështje me rëndësi, duke filluar nga transparenca, që u përmend, dhe të gjitha ecuritë e tjera, por unë do të ndalem më shumë tek edukimi mediatik, duke përforcuar edhe opinionin e zotit Spaho.

Unë mendoj se programet për fëmijë janë shumë të rëndësishme për edukimin publik dhe ky është një fakt i njohur nga të gjithë. Ato e luajnë këtë rol kyç, por unë shoh një ngërç te RTSH-ja, pra te ky televizion kombëtar, kur flasim për programacionet e fëmijëve. Unë i përkas një brezi të ri dhe mund të them këtu se brezi i ri nuk ka interes te programacionet e RTSH-së. Familjet e reja nuk kanë pasur mundësi t'i angazhojnë fëmijët e tyre me programacione për fëmijë, sepse nuk ka, përveç te RTSH Shkolla, që është një iniciativë shumë e mirë, gjithmonë pozitive; diçka që luan rol në edukimin mediatik dhe edukimin e qytetarëve, patjetër ka një rëndësi shumë të madhe dhe duhen përforcuar.

Në këtë aspekt, duke marrë parasysh që u përmend se do të ketë në qershor thirrje për projekte, unë do të doja të dija nëse është konsideruar ideja ose një projekt që mund të realizohet mbi bazën e animacionit, pra programe të animuara, të cilat janë pronë e RTSH-së, duke qenë nisja ose pikënisja e disa videove të animuara, që të jenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...prodhim ose hapje projekti me burim të jashtëm. Kjo është diçka për të cilën mund të na informojnë më shumë drejtorët e programacioneve. Shoh se ka një trend në botë, ku secili shtet ka programacione të dedikuara, që janë programacione që nisin nga vetë qytetarët dhe janë në shërbim të qytetarëve të tyre, qoftë ata gjermanë, francezë, italianë, duke përforcuar identitetin kombëtar si fillim. Ato mund të jenë video të animuara për grupmoshat e reja, për fëmijë që mund të jenë në kopsht ose klasë të parë, për t'iu dhënë atyre mundësinë e një videoje të animuar, e cila është tërheqëse, por ku mund të përfshihen këngët, që ndikojnë ndoshta në edukimin didaktik, si edhe duke iu dhënë atyre mundësinë që çdo familje e re shqiptare të orientohet te “RTSH Fëmijët” ose “RTSH Shkolla” për këto programacione dhe të mos jenë të detyruar fëmijët të dëgjojnë çdo këngë të mundshme në anglisht. Sepse sot, fëmijët tanë para se të flasin shqip, dinë çdo këngë në anglisht. Nuk e di nëse kjo përgjegjësi mund të bjerë vetëm mbi RTSH-në. Patjetër duhet të krijohet mundësia e përforcimit të kësaj ideje edhe nga institucionet e tjera, për t'iu ardhur në ndihmë, por mendoj se është shumë e rëndësishme për të bërë evidentimin e këtij projekti. Nëse fillojmë këtë, ne do të kemi krijuar ose do të kemi hedhur një hap në forcimin e identitetit kombëtar. Pra, të gjitha këngët që sot fëmijët i njohin, janë këngë në anglisht, italisht, gjermanisht, nuk ka asnjë këngë në shqip, pra janë argëtuese për ta, por nuk janë asnjëherë në shqip. Dhe unë këtë e shoh si shumë shqetësuese, sepse ne nuk po orientojmë dot fëmijët tanë dhe familjet e reja

për t'i mësuar fëmijët që në gjenezën e tyre me identitetin kombëtar. Për mua ky është një shqetësim dhe që doja ta theksoja.

Gjithashtu, duke lexuar edhe raporte të tjera, doja të flisja edhe për përfaqësimin e drejtë dhe gjithëpërfshirjen sociale. Në një raport shpjegohej që mediet publike, por sidomos në rastin tonë, RTSH-ja, kishte një tregues të rrezikshëm që thoshte se 60% është treguesi i aksesit në media të minoriteteve, dhe ky ishte në një raport të vitit 2021 në bashkëpunim me BE-në. Unë doja të dija: a kanë ndryshuar këto vlera, pra a kemi në një gjithpërfshirje sociale për minoritetin, duke iu dhënë atyre aksesin në medie dhe duke i përfaqësuar ata në gjithpërfshirjen sociale?

Gjithashtu, për të përforcuar mendimin e parë, edukimi mediatik ishte në vlerën 71%, duke u cilësuar si një rrezikshmëri e lartë, pra do të thotë që nuk ka pasur ndoshta edhe efektivitet në raport me qytetarët shqiptarë në këto programe ose programacione që janë zhvilluar në RTSH.

Gjithashtu, dua të shtoj, çdo gjë e kam të shkruar, se ky tregues shpreh që politikat për edukimin mediatik në Shqipëri janë të pazhvilluara dhe jo të mirëzbatuara. Doja të dija, nëse gjatë këtyre dy vjetëve është bërë një ulje e kësaj përqindjeje që quhej “rrezikshmëri e lartë”, për të parë vërtet si kemi përformuar në vitet 2021-2022?

Unë, gjithashtu, doja të theksoja dhe diçka, këtu ju përmendet që në kohën televizive të programacioneve të RTSH-së ka qenë edhe protesta në mars. Nuk e di cila ka qenë protesta që ka marrë kohë televizive në mars, por një çështje që ma kanë evidentuar dhe sjellë në vëmendje, është që protesta e banorëve të Bërçullës nuk ka pasur transmetim televiziv nga RTSH-ja në kohë reale dhe një publikim i një lajmi ka qenë me burim foton e televizionit “Syri.Net”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, në lajme. Kjo është diçka që e verifikova vetë në faqen zyrtare të lajmeve të RTSH-së. Nuk e di nëse informacioni është i gabuar, por kjo është një nga shenjat që ne nuk kemi gjithpërfshirje sociale ose ndoshta ka indikacion për ndikim politik. Kjo mund të jetë një nga ato.

Në veprimtarinë time si deputete, kam qenë gjithmonë një zë i fortë për të siguruar transparencë. Mendoj se ne në Shqipëri kemi një problem shumë të madh, kur vjen puna te mirinformimi dhe transparenca dhe të gjitha çështjet që janë evidentuar nga Shërbimi i Monitorimit, janë të gjitha çështje reale dhe duhet të kenë rëndësi. Pavarësisht se këtu u fol për transparencën, thjesht dua ta ritheksoj se të gjitha këto rekomandime duhet të vihen në zbatim, sidomos kur vjen puna te rekomandimi për publikimin e raportit ekonomik vjetor dhe financiar. Ne duhet të kemi një mundësi që, para se të zhvillohet kjo seancë, të kemi një raportim shumë të saktë,

për të parë ku keni çaluar dhe si janë përdorur këto fonde, dhe jo vetëm ne si institucion monitorues, por i gjithë publiku.

Pra, edhe një herë dua të ndalem te disa rekomandime: duhet të kemi programe argëtuese, edukative dhe didaktike në lidhje me fëmijët. Ndoshta “RTSH Shkolla” dhe “RTSH Fëmijët” duhet të bëhen bashkë, nuk e di nëse kjo është një mundësi, sepse pasja e kaq shumë kanaleve më duket se ka sjellë një performancë më të ulët të RTSH-së, pavarësisht se ju e shpjeguat që ka edhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në këtë vendim; bërja transparente e veprimtarisë së KDRTSH-së, që është esenciale për të gjithë publikun shqiptar. Dhe një rekomandim që vlen të përmendet është që në RTSH-Kuvendi të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese, të cilat mund të realizohen nëpërmjet bisedave, intervistave apo analizave profesionale të fushës mbi projektligjet. Ky është një rekomandim nga ekspertët dhe mendoj se është një rekomandim me vlerë, sepse kështu ne rrisim nivelin e mirëinformimit, duke hequr dhe ato hendeqe që lihen në zonën gri të dezinformimit, ose lajme të rreme që dalin në lidhje me ligjet ose projektligjet që publikohen.

Shpresoj që disa nga këto rekomandime të merren në konsideratë.

Faleminderit!

Leka Bungo - Zonja deputete shtroi një problem që është thelbësor për ne, por kur bëjmë raporte, zakonisht bëjmë krahasim me 1938-ën dhe themi se kemi qenë më mirë sivjet. Zonja trajtoi problemin e fëmijëve, por ne për fëmijët s’kemi jo programe, por nuk kemi as redaksi për fëmijët. Te ne kanë humbur “Përralla”, që kanë qenë 60 vjet. Te ne janë vetëm ato anglisht. Për ju që nuk e dini, mund ta kuptoni se ato bëhen me tendera, kurse programet e gjalla nuk kanë tendera.

Tani ne nuk kemi jo vetëm program për fëmijë, por nuk kemi as departament për fëmijë. Ne nuk kemi departament për spektakël, për atë që ju po thoni, programe artistike-kulturore, ne nuk kemi departamente për këto. Janë shuar, kanë ikur nga struktura, prandaj unë ngula këmbë dhe po ju lutem që të rishikohet statuti, që të kemi mundësi të vëmë këto që duhen. Nuk të lë ai, të thotë “jo”, ne marrim vendime për këtë, por ai thotë: “jo”. Mbaron kjo punë. Këto janë pasojat pastaj që rrjedhin, prandaj unë them që ju keni plotësisht të drejtë. Sidomos për fëmijët situata është shumë delikate, fëmijët kanë nevojë, por edhe brezi i ri ka nevojë për programe. Ne nuk kemi program. Unë jam i bindur që po të nxjerrim në ekran tani, po them, Tefta Tashkon, nuk e njeh rinia jonë, Tano Banushin, Loro Kovaçin, Pjetër Gjokën, sportistët, Loro Boriçin po ta nxjerrësh, nuk e njeh

rinia jonë, sepse nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Flas për emisionet didaktike, sidomos emisionet për fëmijë. Dhe unë mendoj se ky është një nga problemet serioze që ne duhet ta zgjidhim, por kjo nuk zgjidhet. Çelësi i portës së jashtme është statuti. Po nuk hymë në oborr, nuk bëjmë dot gjë nëpër dhoma. Ne nuk kemi çelësin, kjo është historia.

Petro Koçi - Sigurisht, dhe statuti është një mekanizëm, por unë besoj se do një koncept dhe një platformë më të qartë për të përfshirë gjithë këto interesa, që, në fakt, nuk janë politike, por janë shoqërore, kanë lidhje me vlerat tona kombëtare në çdo fushë artistike, sportive, veçanërisht interesi për fëmijët dhe rininë duhet të jetë i veçantë.

Tani përgjigje më konkrete për çështjet që ngriti zonjusha Ulliri?

Melsi Qirici - Për të dyja, po e bëj gjithëpërfshirëse, edhe për kryetarin, që të mos zgjatem shumë, ne kemi një departament të dedikuar për fëmijët, është një redaksi që drejtohet nga njerëz me eksperiencë në këtë fushë, që kanë mbi 20 vjet në medie për programet për fëmijë dhe aktualisht angazhohen dhe me kanalin e fëmijëve, dhe me kanalin e shkollës, me strukturën e dy kanaleve, duke qenë se ka njerëz ekspertë që janë marrë dhe me pjesën didaktike edhe me emisionet për fëmijë. Ne kemi prodhuar shumë emisione për fëmijë dhe vidoje dhe prodhojmë, që janë gjithëpërfshirëse. Një emision me karakter shkencor dhe edukues është emisioni “Reaksion”, ku fëmijët mësojnë dhe bëjnë eksperimente të ndryshme. Mund ta ndiqni çdo fundjavë në RTSH 1. Janë prodhuar diku rreth 300 episode me një aktor, i cili në një studio të improvizuar bën eksperimente dhe shpjegon fenomene të caktuara shkencore për fëmijët; është një tjetër cikël “Roza dhe Rudi” që bën pikërisht atë, që ju me shumë të drejtë e sugjeruat, me disa animime të vogla dhe muzikë të kompozuar enkas nga një kompozitor, rubrika të ndryshme didaktike, kjo është për parashkollorët, është për fëmijë më të vegjël që mësojnë gjëra të vogla të edukimit ditor, që nga higjiena deri te pjesa e shëndetit për mjekësinë. Do të thotë edhe ky është për pjesën parashkollore. Kemi prodhuar një emision se çfarë janë sekretet, i cili është realizuar pas pandemisë dhe për shkak të kërkesave të shumta jemi detyruar ta ritransmetojmë, sepse ka pasur interes të jashtëzakonshëm, ku fëmijët shprehin emocionet e tyre. Është bërë dhe me një kastë psikologësh të specializuar, të cilët njohin dhe emocionet e fëmijëve nga mosha 5-9 vjeç dhe episod pas episodi fëmijët përshkruajnë çfarë është dashuria, familja, si e shohin ata bulizmin dhe fenomene të tjera që janë të prekshme për fëmijët e kësaj grupmoshe. Emisioni që vijon është “Luaj me mua”, është në çdo ditë të javë, është një emision i ri, që ka në fokus fëmijët nga mosha 5-10 vjeç. Herë pas here ndryshohet edhe target-grupi për shkak të kërkesave që vijnë javë pas

jave, se fëmijët nuk i refuzon dot kur vijnë dhe shprehin interesin për t'u bërë pjesë e programit, ku siç ju thashë ftohen personazhe të ndryshme, të fushave të ndryshme, qoftë nga sporti, nga shëndetësia, nga showbiz-i, pra janë personazhe të ndryshme, janë ftuar edhe figura të RTSH-së, në lidhje me atë që tha kryetari, që fëmijët të njihen edhe me njerëz që kanë dhënë kontribut. Një nga rubrikat është pikërisht për atë që kryetari përmendi, fëmijët njihen me Vaçe Zelën, Parashqevi Simakun, Kozma Dushin. Pra, fëmijëve iu tregohen video të vogla të artistëve të njohur në mënyrë, që ata, përveçse të tregojnë habinë për ata që nuk i njohin, marrin edhe një informacion të vogël me video.

Referuar asaj që ju thatë, që për mua ishte më e rëndësishmja, animimi është një fushë që ne aty realisht duhet të investojmë. Ka kosto të madhe të prodhosh produkte të animuara origjinale, si ato që ka prodhuar Kinostudio dikur, sepse është shumë e kushtueshme. Ne na kanë ardhur disa propozime në RTSH për projekte qoftë dhe me fondin e prodhimit të pavarur, por nuk kanë qenë cilësore nga ana e animimit dhe nga ana kinematografike. I presim, sigurisht, me ardhjet e reja, jemi të hapur, por ju bëj me dije se kostot për realizimin e tyre janë shumë të larta për realizimin e filmave të animuar, jo vetëm te ne, por edhe në botë. Në mungesë të tyre, ne marrim kontakte me të gjitha ambasadat që janë në Shqipëri apo institucionet që të na dhurojnë produkte, të cilat i dublojmë për fëmijët, sepse moshat e vogla preferojnë t'i dëgjojnë të dubluara programet e animuara. Këtë vit kemi marrë nga ambasada japoneze disa cikle të animuara për fëmijë, të cilat janë të gjinisë *manga*, që janë shumë interesante për moshën *junior* dhe i kemi dubluar. Edhe kjo është një gjë e kushtueshme, sepse duhen bërë me zëra, me aktorë, por është investuar në këtë drejtim me idenë për të mos e humbur. Çdo ditë ka një produkt për fëmijët në RTSH. Në RTSH1, siç e bën dhe BBC-ja që ka një dritare të caktuar për fëmijët e vegjël dhe moshën *junior*, ne kemi një dritare që iu kushtohet fëmijëve qoftë me produkte të blera filmike, qoftë dhe me programe, të cilat ne i vendosim në fundjavë.

Andia Ulliri – Të gjitha këto janë shumë pozitive, këtë nuk mund ta mohoj, sepse nuk mund të mohoj asnjë kontribut që jepet në këtë fushë, nëse ka fëmijët dhe të rinjtë në fokus, por theksin e vura te fëmijët, sepse ajo është grupmosha më sensitive dhe aty nis çdo gjë.

A keni pasur projekte, të cilat lidhen me një thirrje të hapur për filma të shkurtër të animuar, që mund të jenë nga të rinj ose shqiptarë, ku mund të tregohen disa histori të vogla të shkurtra? Dhe ato janë shumë interesante, sepse gjithmonë kanë një mesazh në fund, dhe kam parë

që kanë një ndikim pozitiv te moshat e reja. Nuk po flas për lidhjet që mund të ketë me filmat e animuar që mund të blihen, por që të ketë një projekt, thirrje e hapur në drejtim të këtij projekti.

Melsi Qirici - Nuk kanë ardhur me metrazh të shkurtër, ato janë po aq të kushtueshëm sa filmimet me metrazh të gjatë, në fakt. Te thirrja që kemi bërë, fondi i prodhimit të projekteve të pavarura, në këtë vit kemi kërkuar prodhimin e një seriali, duke qenë se është i kërkuar nga publiku, fondi nuk e lejon që ne të bëjmë 2-3 aplikime brenda vitit, pra jemi të detyruar që një lloj buxheti të caktuar ta alokojmë për një produkt dhe duke qenë se këta kushtojnë, nuk e ndajmë dot fondin e prodhimit për të marrë. Kanë ardhur filma me metrazh të shkurtër, por jo në këtë gjini që ju e përmendët, për fëmijët. Kanë ardhur filma artistikë, kryesisht nga prodhime eksperimentale të rinjve që mbarojnë shkollën për film ose regji.

Petro Koçi - Faleminderit!

Lidhur me atë që tha kryetari i Këshillit, për njohjen me figura me shumë vlerë që ka pasur Shqipëria në fusha të ndryshme, unë besoj se vetë arkivi i RTSH-së duhet të ketë materiale të jashtëzakonshme, me të cilin mund të bësh dokumentar, ndoshta jo shumë të gjatë, mbase edhe të shkurtër.

Unë shoh një teknikë televizive në disa kanale të huaja, që në mes të një programi të caktuar, fut një dokumentar 2-3 minuta, që mendoj se është me një efekt të jashtëzakonshëm, dhe mund të ishte një teknologji e tillë. Gjithsesi është mendimi i një politikani, jo i një profesionisti.

Po, zonja Zake.

Enslemvera Zake - Faleminderit!

Mua më vjen keq që për të dytin vit radhazi dëgjojmë konflikte të vazhdueshme që ka Këshilli Drejtues i RTSH-së me organet e tjera që është Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit. Dhe mbase ky konflikt, edhe ju si talente, përfaqësues dhe personalitete, ju ka penguar në ecurinë dhe vazhdimësinë e punës së RTSH-së, duke ju bërë të fokusoheni te konfliktet, burokracitë dhe te mosshpalosja e talenteve dhe të gjithë energjive e potencialit që ju keni për të zhvilluar RTSH-në.

Këtu u trajtua disa herë edhe nga ju, por edhe nga problematikat që kolegët kanë prezantuar, lidhur me gjërat teknike që ju keni, duke humbur fokusin nga raporti i përgjithshëm vjetor që ju keni për të raportuar te komisioni ynë. Shpeshherë Këshilli Drejtues shënjestron Drejtorin e Përgjithshëm apo Bordin Drejtues për mungesë transparence të vendimeve apo vendime të jashtëligjshme, ndërkohë që në raportin tuaj apo në faqen e *web-it* nuk ka vendime të

zbardhura jo vetëm të Këshillit Drejtues, por as të Bordit të Administrimit, as të Drejtorit të Përgjithshëm. Kështu që transparencja nga tri organet drejtuese të RTSH-së është në mungesë dhe kjo mungesë transparence ju është vënë në fokus edhe në raportimin e vjetshëm që keni bërë, ku nuk keni prezantuar dhe ne kemi një mungesë të theksuar informacioni për atë çfarë funksionon në RTSH. Dihet që për gjithçka që lidhet me programacionin, me projektet, me zhvillimin e RTSH-së është Këshilli Drejtues, por nuk e di pse shpeshherë ju thoni se nuk keni programe, nuk keni, ndërkohë që jeni ju organi i cili bëni planin apo strategjinë e RTSH-së në drejtim të projekteve apo programacionit, ndërkohë që Bordi i Administrimit merr vendimet financiare dhe administrative, që ju mbështet me fonde, dhe drejtori i Përgjithshëm është organi ekzekutues i dy organeve kolegjalë që janë me 10-15 anëtarë. Duke qenë se vij nga një institucion që ka funksionuar me borde, por kam edhe një eksperiencë të gjatë në fushën financiare të RTSH-së, e njoh shumë mirë se si funksionon. Pra, drejtori i Përgjithshëm është ekzekutori i dy vendimeve kolegjiale të dy organeve drejtuese, që është Këshilli Drejtues, që merret me programacionin, me idenë kreative dhe potencialin zhvillues dhe Bordi i Administrimit, që merret me mbështetjen e këtyre projekteve për pjesën e ekzekutimit financiar dhe mirëmenaxhimin e fondeve të RTSH-së. Kështu që mungesa e transparencës është nga të tria këto organe.

Meqenëse po fokusohem pikërisht te pjesa financiare, në raportin që ju keni cituar, por edhe nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, rezulton se në vitin 2021, por edhe në vitin 2022, RTSH-ja e ka mbyllur me detyrime të larta ndaj palëve të treta, të cilët janë furnitorë vendas dhe të huaj, institucione financiare dhe detyrime nga shteti. Ju si institucion keni një detyrim prej 1 miliard e 170 milionë lekësh kundrejt Ministrisë së Financave të siguruar me një kredi apo me një garanci shtetërore, por keni edhe një detyrim ndaj Deutsche Bank në vlerën 975 milionë. Ky detyrim vazhdon i mbartur vit pas viti, për shkak edhe të mosarkëtimit të të ardhurave të mbartura, që keni nga viti 2021 apo kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

Kam një pyetje teknike dhe specifike për bordin e administrimit apo edhe për institucionin ekzekutues, që është Drejtoria e Financave pranë drejtorit të Përgjithshëm: pse vazhdojnë të mos arkëtohen këto të ardhura të lidhura nga kontratat e mëhershme?

Së dyti, në faqen tuaj *online*, por edhe në informacionet që na kanë ardhur neve, si komision, mungon raporti që bën RTSH-ja lidhur me veprimtarinë e vet financiare për vitin 2022, si raporti i veprimtarisë së Këshillit Drejtues, po ashtu edhe i Bordit të Administrimit. Pra, ju shpeshherë kërkon mbështetje, qoftë edhe për ndërhyrjet që ne mund të bëjmë në statut, që,

përsëri, nuk është kompetencë e Komisionit të Edukimit dhe Medias për të ndërhyrë në statut, pasi statuti hartohet nga të tjera organe, dhe patjetër që ne mund t'ju mbështesim me aq informacione sa kemi, por ne kemi mungesë të theksuar të informacionit të veprimtarisë suaj si institucion. Kjo për arsye se në Kuvend dhe specifikiqisht në Komisionin tonë të Edukimit dhe Medias nuk janë paraqitur raportet që ju e keni si detyrim ligjor për t'i paraqitur në fund të vitit.

Gjithashtu, kam edhe një pyetje lidhur me proceset gjyqësore që ju keni. Në fund të vitit 2022 keni pasur procese gjyqësore dhe keni ekzekutime vendimesh që i keni në proces, por edhe ato të cilat janë mbyllur kanë një efekt financiar për largime apo procese që mund të keni me kontratat e mëparshme. Unë kërkoj një informacion lidhur me detyrimet apo me borxhin që i kanë shkaktuar RTSH-së këto procese gjyqësore, të cilat nuk janë paraqitur në raport. Si do të mbulohen këto efekte financiare?

Kam edhe diçka në lidhje me shpenzimet. Ju keni raportuar si i keni realizuar të ardhurat për vitin 2022, por edhe shpenzimet, dhe shikoj që në disa zëra i keni tejkaluar në masën 102%, materiale lëndë djegëse dhe organizma ndërkombëtarë në masën 106%. Këto shpenzime a janë bërë me vendim të Bordit të Administrimit, duke rialokuar fondet? Sepse të tejkalosh fondin 100% në një zë do të thotë që ke rialokuar fondet e paharxhuara nga një zë tjetër. A janë këto transparente? A janë marrë me vendim të Bordit të Administrimit, të drejtorit të Përgjithshëm apo me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, që ju keni brenda institucionit? Sepse autonomia financiare shpeshherë tejkalon edhe pjesën burokratike institucionale, që duhet ndjekur në mirëfunksionimin e këtyre organeve drejtuese.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Zake!

Përgjigjja le të jetë nga Bordi i Administrimit.

Knidi Bashari – Në cilësinë e kryetarit të Bordit të Administrimit të RTSH-së, doja të bëja një saktësim për mënyrën e funksionimit të bordeve të administrimit.

Bordi i administrimit është organ kolegjal këshillimor, jo ekzekutiv. Pra, nuk merr vendime për ekzekutim, por në bazë të raporteve që vijnë, krijon idetë e tij dhe këshillon dy institucionet e tjera në bazë të performancës dhe mënyrës se si do të realizohen shpenzimet, ku do të rialokohen e të tjera. Nuk është objekt sot që të bëjmë prezantimin e çdo detaji të buxhetit se si është realizuar, cilat kanë qenë shpenzimet, cilat kanë qenë të ardhurat, pse nuk janë realizuar e të tjera. Të gjitha shqetësimet e komisionit do të adresohen patjetër në çdolloj raporti apo në mbledhjet e radhës në kuadër të transparencës.

Ajo që dua të them, të paktën kjo që më vjen ndër mend tani për shpenzimet dhe të ardhurat, me sa di unë nga pjesa këshillimore, jo pjesa ekzekutive, të ardhurat e RTSH-së janë realizuar në të gjitha zërat dhe ka qenë një vit i mirë në pikëpamjen e të ardhurave, pasi është futur edhe pjesa e marketingut të Botërorit. Pastaj, për pjesën e menaxhimit dhe për pjesën e arkëtimit të të ardhurave patjetër që ka vend për përmirësim dhe RTSH-ja do të adresojë të gjithë problematikën e saj, që këto të ardhura të rriten në vazhdimësi.

Në lidhje me shpenzimet, pra pse shpenzimet në zërin e institucioneve ndërkombëtare janë rritur dhe pse kjo ka qenë në 106%, me sa di unë, të paktën, ato janë shpenzime që vijnë falë detyrimeve që ne kemi për anëtarësimin në këto institucione ndërkombëtare dhe nuk kemi mundësi që të ndryshojmë një tarifë anëtarësimi, ku përsëri rialokimi nuk vjen nga bordi i administrimit. Bordi i administrimit thjesht sugjeron që të vazhdojë pagesa për anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare ku RTSH-ja duhet të aderojë dhe kjo pastaj ekzekutohet nga programet e tjera të ekzekutimit të RTSH-së.

Patjetër, çdo detyrim që ka institucioni do të zbatohet dhe në qoftë se ka pasur mungesë raportimi për shpenzimet financiare, për të ardhurat e të tjera në mbledhjen e radhës apo kur ne do të paraqesim realizimin e buxhetit të RTSH-së për vitin 2022 do të adresojmë të gjitha përgjigjet e pyetjeve tuaja. Nuk e di në qoftë se drejtori i Përgjithshëm ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar, por ne i morëm shënim të gjitha shqetësimet dhe do t'i adresojmë të gjitha çështjet.

Petro Koçi – Këtu të gjithë ankohen për mungesë pushteti.

Zoti nëndrejtor, besoj se është e nevojshme që të thoni diçka.

Redi Neziri – E vetmja gjë që doja të shtoja nga sa tha edhe kryetari i Bordit është pjesa që në pjesën e programeve ndërkombëtare lufta në Ukrainë dhe sanksionet që janë vendosur ndaj Ruisë dhe disa vendeve të tjera, solli sanksionimin e këtyre vendeve nga ana e institucionit më të lartë tek i cili ne aderojmë, EBU-së, dhe shkak për këtë pjesë që ka një ngritje aty është pikërisht kjo. Edhe nga ana e tyre ka pasur një rilokim të të gjithë ndarjes së buxheteve, që paguan secili nga vendet anëtare dhe kjo është reflektuar jo vetëm në pjesën që ne detyrohemi si kuotim karshi kësaj organizate, por edhe karshi të të gjitha eventeve artistiko-kulturore në të cilat ne marrim pjesë dhe aderojmë, që është Eurosong dhe Junior Eurosong.

Kjo është pjesa që doja të thosha, pastaj për gjithçka tjetër që u fol këtu sot, në detyrën që aktualisht jam i ngarkuar, por edhe si pjesë e këtij institucioni që kam qenë më parë, mendoj se çfarë u tha është realisht ajo çfarë duhet bërë që ky televizion të shikohet me shpirt dhe me zemër

për të ecur përpara. Ne jemi munduar ta bëjmë këtë gjë, i gjithë stafi aktual po punon në këtë drejtim dhe unë mendoj se, pavarësisht të gjitha përpjekjeve që kemi bërë, duhet të punojmë më tepër. Për çdo gjë që u fol këtu, sigurisht, do të merren masa edhe për pasqyrimet e të gjithë punës sonë në mënyrë sa më transparente, por besoj se janë rregulluar shumë gjëra.

Në lidhje me një pyetje që u bë pak më parë për sa i takonte pjesës së marketingut doja të thosha se është e vërtetë dhe në vitin 2022 të adhuroat e RTSH-së kanë qenë shumë të larta, por nuk është ky vit që duhet marrë si referencë m, sepse realisht ne kemi probleme të mëdha për pjesën e marketingut, jo si rezultat i një pune të dobët nga sektorët përkatës, por për shkak edhe të vetë tregut dhe mënyrës së qasjes së klientëve ndaj RTSH-së. Unë mendoj se ka shumë gjëra që duhet të rishihen, si procedurat, burokracitë. Gjithashtu, edhe për pjesën e ligjit të RTSH-së kam përshtypjen se duhet ta shikojmë të gjithë së bashku dhe mendoj se duhet ta rikonceptojmë ligjin për RTSH-në, bazuar edhe në disa ligje të vendeve të tjera europiane.

Sigurisht, në bazë të takimeve që kemi pasur me organizmat ndërkombëtarë në të cilat ne aderojmë jam shumë i bindur se ata janë shumë të hapur të na ndihmojnë, por kjo bëhet në bashkëpunim me ju dhe të gjithë ne për të ribërë një ligj që të na japë edhe ne dorë si televizion publik që të rrisim konkurrencën, e cila u përmend edhe në raport, që është shumë e domosdoshme për këtë treg që kemi.

Aktualisht është e vërtetë që kemi shumë detyrime karshi të tjerëve, ashtu siç është e vërtetë që edhe të tjerët kanë shumë detyrime karshi nesh. Realisht në fund fare, besoj se edhe kryetari i bordit është dakord me mua, sikur ne t'i mblidhnim këto detyrime, që janë me kohë të mbartura, do të kishim më pak detyrime karshi pjesës tjetër. Në të gjitha diskutimet që kam pasur edhe me drejtorinë ekonomike ajo që vihet re është se në pjesën e realizimit të të gjitha të ardhurave të buxhetit ne jemi shumë në rregull. Pra, kemi realizuar të gjitha zërat që duhet t'i realizonim, ndërkohë probleme kemi me pjesën e të ardhurave që na vijnë nga OSHEE-ja, të ardhurat nga ajo që quhet "taksa e aparatit", e cila jo gjithmonë mblidhet dhe vjen parashikimi i duhur.

Sido që të jetë, ne këtu po flasim vetëm për vitet 2021-2022 dhe realisht unë mendoj se të ardhurat nga marketingu kanë qenë më të larta. Edhe ky tregues i tanishëm që ne kemi tregon që realisht të ardhurat janë më të larta, por në këtë pikë jemi dhe vazhdojmë të jemi në përpjekje për të realizuar sa më shumë të mundemi ato targetet që ne kemi.

Gjithashtu, dua të kthehem pak te pjesa e diskutimit që u ngrit, e emisioneve për fëmijë. Realisht gjatë periudhës për të cilën ne po flasim kemi pasur një diskutim shumë të gjatë, sidomos për pjesën e fëmijëve. Midis nesh ka pasur edhe një diskutim shumë të madh në lidhje me shkrirjen apo jo të disa kanaleve, siç është folur edhe për shkrirjen e “RTSH Shkollë”, ku disa propozime janë mbajtur, disa të tjera jo, dhe kjo gjë u bë pikërisht për këtë punë. Të paktën një gjë që duhej theksuar në atë raport është edhe fakti që ne përfundimisht sot mund të jemi nga të vetmit televizione që realisht transmetojmë çdo gjë me të drejta dhe kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Pra, RTSH-ja më në fund po paguan të drejtat e autorit për çdo gjë dhe në momentin e parë kjo na ka sjellë një tkurrje të programeve, sepse rikërkesat apo riorganizimi i këtyre strukturave ka sjellë problematikën e gjetjes së fondeve për të riorganizuar të gjithë strukturën tonë, por edhe për të bërë blerjet e duhura.

Për sa i përket pjesës së programeve për fëmijë, edhe vetë televizionet publike, sikundër e theksoi edhe drejtoresha e programacionit, janë me të vërtetë shumë të ndjeshëm, por programet e fëmijëve realisht kushtojnë. Për prodhime të tilla, siç janë prodhimet animacion, edhe vetë kompanitë e mëdha me të cilat ne aderojmë, janë shumë sensitive në këtë pikë. Madje, kjo nuk i takon vitit 2022, por është një punë e filluar më përpara, sepse realisht në këto lloj procedurash, në këto lloj bisedimesh punët fillojnë më përpara dhe kemi gati 7 muaj që jemi në diskutime me BBC-në, me kompaninë amerikane PBC, që është *Public Broadcasting Company*, apo edhe me kompani të tjera si *Deutsche Welle*. Pavarësisht gjithë dëshirës që ata kanë për të ndihmuar, në shumë raste për këto pika ata ndërhyjnë në të drejtat e autorëve, pasi prodhimet nuk janë të atyre vetë, por janë të autorëve. Pra, edhe ata vetë nuk mund të na suportojnë në këtë pikë. Kështu që është jashtëzakonisht shumë e rëndësishme edhe për ne gjithçka që u tha këtu, sidomos për fëmijët.

Fakti është se, edhe sikur të duam të prodhojmë emisione të tjera, edhe nëse do t’i gjenim të gjitha mundësitë, do të ishte pak problematike pjesa teknike. Megjithatë, unë dua ta mbyll me kaq. Unë besoj se për ne është një detyrë e re, e cila do të realizohet në vazhdimësi, ku gjithçka do të jetë e përfshirë dhe rezultatet do të shihen më pas.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti nëndrejtor!

Unë besoj se, pa e pyetur zonjën Zake, ajo është pjesërisht e kënaqur për përgjigjet, sepse kishte interes më shumë për aspektin ekonomik-financiar, për të dhënë më shumë ekspertizë në përgjigje.

Ju sot jeni pjesë e EBU-së, apo jo? Sepse ata ofrojnë asistencë, që lidhet edhe me legjislacionin dhe me kuadrin rregullues, për të cilën foli edhe kryetari. Unë besoj se ka vend për të intensifikuar bashkëpunimin me ta, ndoshta edhe ne si komision, dhe uroj që me drejtimin e ri të RTSH-së ndodhemi në një fazë të re, në mënyrë që të mos përsëriten të njëjtat ankesa si për njëri-tjetrin, ashtu dhe për situatën në raportimet e vitit që vjen.

Zoti Beqiraj është i fundit, sepse është deputeti më konciz që flet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Ju kërkoj ndjesë pasi këtë bashkëbisedim të sinqertë para këtij komisioni të nderuar nuk do ta quaja llogaridhënie, sepse ky komision e ka për detyrë të dëgjojë me përvullje, jo thjesht për atë çka i keni dhënë ju artit dhe pushtetit të katërt në vendin tonë, por edhe për atë përgjegjësi dhe kontribut që keni në krye të këtij institucioni. Ndaj, unë ju falënderoj dhe me këtë dua ta nis fjalën time, që të dyja pushtetet ose qeveritë në këtë institucion janë këtu prezente në këtë tavolinë! Ndërsa vakancën e keni përballë nga komisioni dhe keni të drejtë të mërzhiteni me ne për këtë fakt.

Sinqerisht, kam fatin që tani jam anëtar zëvendësues në këtë komision, ndaj dhe bëra shkëputje nga komisioni tjetër, ku paralelisht po diskutohej dhe po votohej, për t'ju dëgjuar ju deri në fund dhe për të thënë edhe unë disa fjalë.

Ne nuk ju këshillojmë dot ju për figurën, vlerat dhe kontributet që keni në këtë fushë të caktuar, por kemi edhe ne disa pyetje, gjithmonë duke u bazuar te raporti, që me të drejtë na tërheqin vëmendjen dhe jo se kështu e do zakoni që t'i bëjmë. Sinqerisht, e mora me shumë shqetësim atë që disa herë, i nderuari zoti Leka Bungo, për të cilin kam shumë respekt, shprehu në lidhje me RTSH-në. Kur kemi bërë dëgjesat, para dy vjet e gjysmë, të kandidatëve për Këshillin Drejtues, u lumturuam për njerëzit që u përzgjodhën, u nominuan dhe u votuan. Për këtë ne nuk kemi ndërruar mendim asnjëherë, edhe pse diçka nuk shkon në Radiotelevizionin Shqiptar, gjë të cilën e thanë edhe kolegët e mi, por e thatë edhe ju.

Unë kam të drejtën time ligjore, si një prej 140 deputetëve të këtij parlamenti, për të thënë se çfarë nuk shkon në Radiotelevizionin Shqiptar dhe të jap kontributin tim, me aq sa mundem. Çfarë mbështetjeje kërkon në aspektin e nismave ligjore, se unë e dëgjova edhe nëndrejtorin, dhe ku konkretisht e kërkon këtë mbështetjeje për një reformim të thellë të RTSH-së? Sinqerisht, kur kam dëgjuar idetë dhe vizionet që kishit kur konkurruat dhe bëtë prezantimin tuaj, dhe pse donit të kontribuonit në këtë institucion të rëndësishëm, shpresova shumë që RTSH-ja nuk do të ishte në

këtë gjendje në të dyja shtyllat e saj, qoftë në pjesën e Këshillit Drejtues, qoftë edhe në pjesën ekzekutive, që është drejtori i Përgjithshëm, së bashku me të gjithë zinxhirin komandues të tij.

Pra, çfarë nuk shkon dhe ku e doni ndihmën tonë? Unë nuk marr përsipër të bëj gjithologun, që t'ju jap mendime për një fushë të caktuar që ka poliprofesione dhe që ka mbajtur me dekada të tëra edukimin shpirtëror e kulturor dhe ka ushqyer shpirtin e vendit tonë me kulturë, me shkencë dhe me jetë.

Në kushtet e vështira që kaluam gjatë pandemisë kanali “RTSH Shkolla” ka dhënë një kontribut të madh kombëtar në edukimin dhe formimin e fëmijëve, që nga parashkollorët dhe deri në universitete. Pra, edhe ai rrethim i asaj damllaje që ra në të gjithë botën, pothuajse u çua nëpërmjet këtij pushteti, ndaj me sinqeritet unë jua bëj këtë pyetje.

Pyetja e dytë, që ka shumë rëndësi është: veprimtaria e RTSH-së është bazuar në përshtatshmërinë me sfidat e kohës që kemi realisht? Ne ndeshemi me tregun e shumëllojshëm privat edhe publik, por edhe me një medie të re që është një revolucion digjital në të gjitha fushat e medias digjitale, pra në medien e shkruar dhe në medien audiovizive tradicionale. Për mua ka interes që ne edhe në rezolutën për veprimtarinë vjetore të vitit 2022 të institucionit tuaj, nëse doni, të fusim pikat që duhen, në mënyrë që të ecim. Në vazhdim të kësaj do të bëj një pyetje, që kam bërë edhe më përpara në analiza të tjera vjetore, në lidhje me digjitalizimin. Sa për qind e të gjithë arkivës së RTSH-së është bërë deri më tani?

Ne, si Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, kemi ardhur në institucionin tuaj para 2 apo 3 vjetësh, ndaj nisma të tilla komisioni duhet të ndërmarrë, që ta shikojmë me sytë tanë realitetin. Më intereson, jo vetëm për kulturë, por sepse aty është e gjithë memoria, e gjithë puna, djersa dhe munda juaj, që nga i nderuari Bungo dhe deri tek më i riu. A është e ruajtur apo hyn e del kushdo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A është e ruajtur e digjitalizuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përse duhet që punën dhe djersën tuaj 50-vjeçare ta shesë një tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë e kam shqetësim shumë të madh edhe si qytetar, edhe si deputet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, unë dëgjova kryetarin, i cili me të drejtë foli për strukturën dhe të ardhurat, pra dy shtyllat kryesore, sigurisht që paguhen nga buxheti i shtetit dhe sipas kësaj që keni raportuar kjo shumë është simbolike, por ama është 75% mbi barrën e të ardhurave tuaja.

Të ardhurat e tjera, që vijnë nga shitja e materialeve arkivore e të tjera, zënë vendin e fundit me 2% kontribut, ndërsa reklamat zënë 9%, në një kohë kur televizionet e tjera kombëtare mbahen vetëm me reklama dhe me produktet e RTSH-së.

Nëse ju duhet ndihmë në aspektin ligjor dhe juridik, na thoni. Unë jam një nga deputetët që për shërbimin publik dhe në të mirë të një mase të gjerë, sakrifikoj çdo baltë që hidhet në mendjen tonë.

RTSH-ja duhet të jetë në rrugë të mbarë, ashtu siç është edhe Akademia e Shkencave sot, e cila po zhvillon projekte madhore, si, për shembull, për Fjalorin e Gjuhës Shqipe, për Historinë e Shqipërisë dhe për Enciklopedinë Shqiptare, pra atë kombëtare, jo vetëm të Shqipërisë. Pra, janë tre projekte madhore dhe këto po zhvillohen falë reformimit ligjor. Deri tani kemi reformuar AMA-n, për të cilën kemi punuar edhe në legjislaturën e parë. Ndaj unë e quaj domosdoshmëri dhe i bashkohem këtij shqetësimi.

Që ta mbyll, më tërhoqi vëmendjen një propozim në lidhje me stimulimin e punonjësve dhe specialistëve, pra, se si mund të bëhet ky institucion kombëtar magnet i specialistëve më të mirë të vendit, por edhe të specialistëve nga jashtë. Më pëlqeu si propozim, nuk dua t'i marr autorësinë, por njëri nga kandidatët, më duket i nderuari Bungo apo dikush tjetër, hodhi këtë ide shumë interesante në lidhje me pagat. Pra, specialistët artistë të paguhen mbi bazën e kontributit dhe performancës në institucion, plus edhe pjesën që u jep shteti. A e keni diskutuar ndonjëherë këtë, sepse kjo ide mua më ka ngacmuar shumë? Nuk dua t'i marr autorësinë asnjërit, por më duket se njëri prej jush e ka thënë këtë.

Unë këto kisha. Shpresoj që akujt mes institucionit të RTSH-së të shkrihen sa më shpejt dhe marrëdhëniet t'i kemi pranverë. Këtë komision e keni dhe do ta keni gjithmonë mbështetje, sepse kjo është një çështje me rëndësi kombëtare. Kushdo mund të zëvendësohet, por njerëz me vlera, me kontribute, me CV dhe me *background*-e që kanë tronditur zemrat e njerëzve, siç janë njerëzit e artit dhe të kulturës, nuk zëvendësohen. Ne deputetët mund të zëvendësohemi, ndërsa ju nuk zëvendësoheni dot.

Ju falënderoj!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Nuk ke qenë ndonjë herë më konciz se kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, kam përshtypjen se edhe pyetjet ishin më shumë sugjeruese.

Unë dua të prek çështjen e arkivit, pra materialet që ka pasur Radiotelevizioni Shqiptar, të cilat janë shpërdoruar. Unë flas si një person që është jashtë institucionit, se nuk e di situatën aty brenda, por duke parë mënyrën si është administruar ndër vite, meqenëse po shikojmë se drejtësia e re po vepron, kam përshtypjen se për këtë çështje duhet të investohet drejtësia, sepse është një shpërdorim i madh. Ky nuk është thjeshtë një dëmtim i financave apo i vlerave të institucionit. Në atë arkiv është historia jonë shtetërore, është historia jonë kombëtare, por është një shkelm i rëndë për atë vlerë të madhe. Për mua është patjetër e nevojshme të ketë një veprim të vendosur të drejtësisë.

Ju falënderoj për prezencën!

Rekomandimet i dëgjuat. Nëse keni mundësi, na nisni një kopje të raportit tuaj fillestar, zoti Bungo, sepse na ndihmon në zbardhje. Ne do t'ju dërgojmë një kopje të rekomandimeve tona paraprake, nga të cilat do të donim një koment, pastaj do të vendosim vetë se çfarë do t'i propozojmë seancës plenare.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA